

# VJETARI 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

# YEAR-BOOK 2013

34



PRISHTINA  
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

# VJETARI 2013

34



Redaktor

**Isuf Krasniqi**

Sekretar i përgjithshëm  
i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

## PËRMBAJTJA

### PËRBËRJA E AKADEMISË

|                                                                                    |    |
|------------------------------------------------------------------------------------|----|
| A. KRYESIA .....                                                                   | 7  |
| B. ANËTARËT E AKADEMISË .....                                                      | 7  |
| I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË .....                                      | 7  |
| II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE .....                                           | 7  |
| III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS .....                                         | 8  |
| IV. SEKSIONI I ARTEVE .....                                                        | 8  |
| V. ANËTARËT IN MEMORIAM .....                                                      | 8  |
| VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS .....                            | 9  |
| VII. ANËTARËT E JASHTËM .....                                                      | 9  |
| VIII. ANËTARË NDERI .....                                                          | 10 |
| C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE .....                        | 10 |
| RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2013 .....                                               | 11 |
| I. KUVENDI .....                                                                   | 13 |
| II. KRYESIA .....                                                                  | 13 |
| III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË .....                                    | 28 |
| IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE .....                                           | 31 |
| V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS .....                                           | 33 |
| VI. SEKSIONI I ARTEVE .....                                                        | 37 |
| VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE .....                        | 39 |
| PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2014 .....                                  | 45 |
| PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS ..... | 61 |
| KRONIKË - 2013 .....                                                               | 73 |



## A. KRYESIA

Akademik **Hivzi Islami**, kryetar,  
Akademik **Pajazit Nushi**, nënkryetar,  
Akademik **Isuf Krasniqi**, sekretar i përgjithshëm,  
Akademik **Mehmet Kraja**, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,  
Akademik **Mark Krasniqi**, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore,  
Akademik **Fejzullah Krasniqi**, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës,  
Akademik **Zeqirja Ballata**, sekretar i Seksionit të Arteve.

## B. ANËTARËT E AKADEMISË

### I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

*a) Anëtarët e rregullt (akademikë):*

**Ali Aliu** (1934), i zgjedhur më 2000,  
**Besim Bokshi** (1930), i zgjedhur më 1996,  
**Eqrem Basha** (1948), i zgjedhur më 2004,  
**Idriz Ajeti** (1917), i zgjedhur më 1975,  
**Mehmet Kraja** (1952), i zgjedhur më 2008,  
**Rexhep Ismajli** (1947), i zgjedhur më 1996,  
**Rexhep Qosja** (1936), i zgjedhur më 1975,  
**Sabri Hamiti** (1950), i zgjedhur më 2008.

*b) Anëtarët korrespondentë:*

**Mehmet Halimi** (1937), i zgjedhur më 2012,  
**Zejnullah Rrahmani** (1952), i zgjedhur më 2012.

### II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

*a) Anëtarët e rregullt (akademikë):*

**Ekrem Murtezai** (1931), i zgjedhur më 2000,  
**Esat Stavileci** (1942), i zgjedhur më 2000,  
**Hivzi Islami** (1946), i zgjedhur më 2000,  
**Mark Krasniqi** (1920), i zgjedhur më 1985,  
**Pajazit Nushi** (1933), i zgjedhur më 2008,  
**Isa Mustafa** (1951), i zgjedhur më 2012.

*b) Anëtarët korrespondentë:*

**Arsim Bajrami** (1960), i zgjedhur më 2012,  
**Anton K. Berishaj** (1954), i zgjedhur më 2012,  
**Edi Shukriu** (1950), e zgjedhur më 2012,  
**Jusuf Bajraktari** (1948), i zgjedhur më 2012.

### III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

*a) Anëtarët e rregullt (akademikë):*

**Feriz Krasniqi** (1931), i zgjedhur më 2000,  
**Latif Susuri** (1941), i zgjedhur më 2008,  
**Minir Dushi** (1929), i zgjedhur më 1979,  
**Nexhat Daci** (1944), i zgjedhur më 1996,  
**Fejzullah Krasniqi** (1953), i zgjedhur më 2012,  
**Isuf Krasniqi** (1948), i zgjedhur më 2012.

*b) Anëtarët korrespondentë:*

**Arsim Morina** (1956), i zgjedhur më 2012,  
**Qamil Haxhibeqiri** (1949), i zgjedhur më 2012,  
**Ruzhdi Pllana** (1940), i zgjedhur më 2012,  
**Salih Gashi** (1944), i zgjedhur më 2012.

### IV. SEKSIONI I ARTEVE

*a) Anëtarët e rregullt (akademikë):*

**Engjëll Berisha** (1934), i zgjedhur më 2008,  
**Rauf Dhomi** (1945), i zgjedhur më 1996,  
**Rexhep Ferri** (1937), i zgjedhur më 2000,  
**Tahir Emra** (1938), i zgjedhur më 2008,  
**Zeqirja Ballata** (1943), i zgjedhur më 2000.

*b) Anëtarët korrespondentë:*

**Luan Mulliqi** (1953), i zgjedhur më 2012,  
**Xhevdet Xhafa** (1934), i zgjedhur më 2012.

### V. ANËTARËT IN MEMORIAM

*a) Anëtarët e rregullt (akademikë):*

**Agim Çavdërbasha,**  
**Ali Hadri,**  
**Ali Podrimja,**



**Dervish Rozhaja,**  
**Enver Gjerqeku,**  
**Esad Mekuli,**  
**Fehmi Agani,**  
**Gazmend Zajmi,**  
**Jashar Rexhepagiq,**  
**Muharrem Berisha,**  
**Musa Haxhiu,**  
**Muslim Mulliqi,**  
**Osman Imami,**  
**Remzi Bakalli,**  
**Syrja Popovci,**  
**Vladeta Vukoviq,**  
**Vukasin Filipoviq.**

*b) Anëtarët korrespondentë:*

**Anton Pashku,**  
**Eshref Ademaj,**  
**Hajredin Hoxha,**  
**Ibrahim Rugova.**

## **VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS**

*a) Anëtarët e rregullt (akademikë):*

**Sinan Hasani** (letërsi), Serbi, i zgjedhur më 1986.

*b) Anëtarët korrespondentë:*

**Zef Mirdita** (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1991.

## **VII. ANËTARËT E JASHTËM**

**Aleksandar Stipçeviq** (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1983,  
**Ismail Kadare** (letërsi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991,  
**Wilfried Fiedler** (gjuhësi), Gjermani, i zgjedhur më 1991,  
**Eric Hamp** (gjuhësi), i zgjedhur më 1991,  
**Shaban Demiraj** (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 1996,  
**Gunnar Svane** (gjuhësi), Danimarkë, i zgjedhur më 1996,  
**Kristian Gyt** (histori e kulturës), Francë, i zgjedhur më 1996,  
**Gjelosh Gjokaj** (art figurativ), Gjermani, i zgjedhur më 1996,  
**Leonard Newmark** (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2000,  
**Robert Elsie** (letërsi), Kanada, i zgjedhur më 2000,

**Michel Roux** (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000,  
**Muhamedin Kullashi** (filozofi), Francë, i zgjedhur më 2000,  
**Tomë Berisha** (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000,  
**Noel Malcolm** (histori), Angli, i zgjedhur më 2004,  
**Victor Friedman** (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004,  
**Emin Riza** (arkitekturë), Shqipëri, i zgjedhur më 2008,  
**Franchesko Altimari** (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2008,  
**Muhamet Mufaku** (histori), Jordan, i zgjedhur më 2008,  
**Alajdin Abazi** (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,  
**Kolec Topalli** (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,  
**Oliver Schmit** (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,  
**Radoslav Katicic** (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012.

### VIII. ANËTARË NDERI

**Ferid Murati**, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur më 2000.

### C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE

**Lendita Pula**, sekretare e Akademisë,  
**Ali Caka**, drejtor i departamentit të përkrahjes profesionale,  
**Vjollca Hykolli**, drejtoreshë e departamentit financiar,  
**Hilmi Zogjani**, përgjegjës i njësisë së bibliotekës,  
**Bedri Pllana**, menaxher i prokurimit,  
**Xhemshit Brajshori**, bashkëpunëtor për marrëdhënie ndërkombëtare dhe  
veprimtari botuese,  
**Hasime Maliqi**, zyrtar certifikues, zyrtar i pasurisë dhe i të hyrave,  
**Lirijeta Bunjaku**, zyrtar për shpenzime – financiar,  
**Lidije Kelmendi**, bibliotekare,  
**Taulant Veseli**, Zyrtar i IT-së, redaktor teknik, zyrtar i shpenzimeve,  
mirëmbajtës i faqesueb, zyrtar për qasje në dokumente publike,  
**Rron Baraku**, Zyrtar i IT-së, radhitës në kompjuter, redaktor teknik,  
zyrtar i pranimit,  
**Burim Rexhepi**, radhitës në kompjuter (redaktor teknik),  
**Dafina Kavaja**, sekretare teknike e Kryesisë,  
**Alban Bytyçi**, shofer-korrier,  
**Valbona Olluri**, punëtore teknike,  
**Avdi Gashi**, librashitës-receptionist.

## RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2013





## I. KUVENDI

Organi më i lartë i qeverisjes - Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në vitin 2013 është mbledhur dy herë. Për herë të parë më 20 shkurt (Mbledhja LXXIX) dhe për herë të dytë më 3 korrik (Mbledhja LXXX).

I. Në mbledhjen e parë të këtij viti, si zakonisht, përveç miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, u shqyrtuan edhe pikat: Raporti mbi punën e Akademisë për vitin 2012; Raporti financiar i Akademisë për vitin 2012 dhe çështje vijuese.

Para shqyrtimit të pikës së dytë të rendit të ditës, kryetari H. Islami në mënyrë përmbledhëse paraqiti vlerësimet e tij për veprimtarinë e realizuar të Akademisë në vitin 2012. Fjala e kryetarit është pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit.

Në vazhdim u shqyrtua raporti i punës së ASHAK-ut për vitin 2012 sipas radhës, duke filluar nga ai i punës së Kuvendit dhe në vazhdim për punën e Kryesisë, të seksioneve deri te raporti i punës së shërbimit administrativ, profesional dhe teknik të Akademisë, i cili u miratua pa vërejtje. Raporti do të botohet në "Vjetari" 2012.

Kuvendi miratoi edhe raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2012.

II. Në mbledhjen LXXX të Kuvendit, mbajtur më 3 korrik, pas miratimit të procesverbalit nga

mbledhja pararendëse u diskutua për programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2014.

Para nisjes së shqyrtimit të programit të punës kryetari H. Islami paraqiti vlerësimet e tij për punën e Akademisë. Fjala e plotë e kryetarit Islami është pasqyruar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje.

Më pas Kuvendi shqyrtoi Programin e punës për vitin 2014, me radhë sipas seksioneve dhe e miratoi në plotni atë.

Programi i punës për vitin 2014 është i pasqyruar në tërësi në procesverbalin e kësaj mbledhjeje dhe do të botohet në *Vjetari 2013*.

## II. KRYESIA

Bazuar në kompetencat dhe obligimet e përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe me Statutin e saj, Kryesia e Akademisë në 10 mbledhjet e vitit 2013 është marrë me shqyrtimin e shumë çështjeve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike do të pasqyrohet aktiviteti i Kryesisë së Akademisë.

1. Kryesia në mbledhjen (XVIII) e 23 janarit miratoi kumtesën lidhur me ngjarjet në Luginën e Preshevës me këtë përmbajtje:

"KUMTESË PËR OPINION E AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

lidhur me ngjarjet në Luginën e Preshevës"

Ndërhyrja e forcave të xhandarmërisë serbe në Preshevë shtyri Kryesinë e ASHAK-ut ta përsëris shqetësimin për gjendjen në të cilën janë shqiptarët e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës. Ky akt i shëmtuar tregoi qartë se regjimi serb dëshiron t'ua shkulë shqiptarëve të Luginës edhe kujtesën për të rënët e tyre në mbrojtje të lirisë nga mësymjet e hordhive ushtarako-policore serbe në vitin 2001. Me këtë akt Serbia u tregoi në mënyrë të përsëritur banorëve të Luginës dhe botës mbarë qëndrimin armiqësor të shtetit të Serbisë ndaj shqiptarëve të mbetur padrejtësisht dhe me lojërat gjeopolitike në mëshirën dhe juridiksionin e shtetit serb. Dhe kjo ndodhi në një kohë kur subjektet e Luginës tashmë ishin në përfundim të marrëveshjes për një zgjidhje të dialoguar për monumentin.

Nuk ka dyshim se ky aksion hyn në radhën e shumë të tillëve të ushtruar nga shteti i Serbisë me synimin e përshpejtimit të procesit të heshtur të spastrimit etnik në Luginën e Preshevës. Para syve tanë tashmë ka ndodhur spastrimi në komunën e Medvegjës pikërisht në këto dy dekadat e fundit dhe po vazhdon edhe në Bujanoc e Preshevë.

Është ky rast që Kryesia e ASHAK-ut e ndien të nevojshme ta përsërisë shqetësimin e saj për gjendjen e shqiptarëve në Luginën e Preshevës të vënë nën tryzni të shumëfishta të drejtpërdrejta nga regjimi serb në vijën e Milosheviqit: trysnive të theksuara dhe të dukshme policore,

ushtarake e administrative dhe të trysnive me efekte afatgjata ekonomike dhe shoqërore. E mbërthyer midis tre kufijve shtetërorë dhe kufirit të egërsisë e të armiqësisë së regjimit serb, popullsia shqiptare e Luginës nuk po ia del dot të gjejë zgjidhje.

Qetësimet e përkohshme me ndërhyrjet e improvizuara të vitit 2001 të drejtuara nga z. P. Feith, pa vendime të qarta dhe detyruese për regjimin serb lidhur me respektimin dhe garantimin e të drejtave të shqiptarëve të Luginës, po e shpërfaqin tani tërë paqëndrueshmërinë e tyre. Në kontekstin e sotëm po duket edhe më qartë efekti i mosevidentimit të çështjes dhe të drejtave njerëzore e kolektive të shqiptarëve të Luginës në bisedimet e Vjenës, po ashtu.

Procesi i dialogut midis shteteve të Kosovës dhe të Serbisë të drejtuar nga BE-ja po e nxjerr edhe më për fushë tërë absurditetin e trajtimit të problemeve të rajonit me standarde dhe parime të dyfishta: një për serbët dhe tjetri për shqiptarët, kudo që janë ata. Ndërkaq, të drejtat e njeriut janë të njëjta gjithandej dhe nuk mund të shihen të shkëputura nga kontekstet politike e të sigurisë.

Para syve tanë po rrjedh procesi i spastrimit të heshtur etnik përmes ikjeve të vazhdueshme nën tryshinë e horizontit të mbyllur, të mungesës afatgjatë të çfarëdo nisme për zhvillim ekonomik e shoqëror, të mungesës së institucioneve të shkollimit të lartë (ndërkohë që nuk u njihen diplomat e Kosovës), të

shëndetësisë deri edhe më elementare, të nismave për zgjidhjen e problemeve reale 7-8 herë më pak të zhvilluar se mesatarja e viseve të tjera të Serbisë, ndërkohë që popullsia është privuar nga komunikimi normal me amën, të gjitha këto të kombinuara me ndërhyrje të herëpashershme brutale me synim të drejtpërdrejtë përshpejtimin e këtij procesi të spastrimit etnik. Në të njëjtën kohë bie në sy edhe mungesa e angazhimeve substanciale, sistimore institucionale të Shqipërisë dhe të Kosovës në drejtim të krijimit të çfarëdo kuadri për lëvizje që do të krijonin hapësirë për evitimin apo zbutjen e pasojave të këtij procesi.

Kryesia e ASHAK-ut nuk mund të mos e shpreh zhgënjimin për neglizhencën e dukshme të mekanizmave evropianë dhe ndërkombëtarë, të cilët, me standardet dukshëm të dyfishta dhe me mbështetjen që po i japin këtij regjimi në integrimet evropiane pa i përmbushur standardet e respektimit të të drejtave njerëzore e kolektive të shqiptarëve, po i fryjnë agonisë dhe po bëhen pjesëmarrës në këtë proces të dhimbshëm e të heshtur të Luginës së Preshevës.

Gjithë duke mbështetur përpjekjet që po bën Kosova për stabilizimin e raporteve me minoritetet dhe serbët, Kryesia e ASHAK-ut kërkon nga mekanizmat qeveritarë të Kosovës që të kërkojnë rrugë dhe mjete për zgjidhjen e problemeve reale dhe të hapjes së horizontit të shpresës për zhvillime më pozitive për shqiptarët e

Luginës. Është e qartë se gjendja e përgjithshme e shqiptarëve të Luginës, trysnia e përgjithshme politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e policore-ushtarake është e lidhur me synimin e regjimit serb për të grabitur hapësira e territore shqiptare pa shqiptarë, çka nuk mund të jetë e pranueshme për raportet evropiane të shek. 21. Ndihamat që mund t'i jep Kosova në këtë drejtim duhet të jenë në harmoni me ofertat dhe mundësitë që krijohen për minoritetet e Kosovës dhe kjo duhet të sigurohet në të njëjtin proces me ndërmjetësim ndërkombëtar. Çështjet kështu të ndjeshme për rajonin dhe me kaq potencial destabilizues nuk mund të lihen në dorë të vullnetit policor të ish-zëdhënësit të Millosheviqit, sot Kryeministër i Serbisë, i cili nuk ngurron të ndërmarrë hapa hapur represivë ndaj popullatës shqiptare dhe të zgjedhurve e institucioneve legjitime të saj në vendin e vet.

Kryesia e ASHAK-ut shpreh tërë solidarizimin me popullatën e Luginës së Preshevës dhe me kërkesat e saj legjitime për të gjetur zgjidhje sistimore, institucionale dhe administrative të ndërmjetësuara edhe ndërkombëtarisht që do ta garantonin ekzistencën dhe jetën normale të saj në trojet e veta.

Kryesia e ASHAK-ut kërkon nga popullata e Luginës së Preshevës ta ruajë gjakftohtësinë dhe të mos bjerë pre e provokimeve të regjimit serb. Kryesia e ASHAK-ut kërkon nga popullata e Kosovës, po ashtu, të



përmbahet nga çdo lloj veprimi të dhunshëm ndaj të tjerëve në Kosovë.

Kryesia e ASHAK-ut shpreh shpresën që mekanizmat e BE-së, nëse vërtet duan të ndihmojnë për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme, t'i shtojnë në mënyrë serioze dhe me të njëjtat kriteret të gjitha problemet në rajon.

Prishtinë, 23.1.2013

PËR KRYESINË E ASHAK-ut

Akademik Hivzi ISLAMI, kryetar

U vendos që kumtesa t'u dërgohet medieve.

Pas miratimit të kumtesës Kryesia u mor edhe me çështje të tjera si: mori vendim mbi vazhdimin e punës së Këshillit bashkërendues për Monografinë Kosova - versioni anglisht edhe për vitin 2013; mori vendim për vazhdimin e punës së redaktorëve të fushave përkatëse për Monografinë Kosova - versioni anglisht edhe për vitin 2013; mori vendim që prof. dr. Vesel Nuhiu të caktohet Koordinator i përkthimeve për Monografinë Kosova – versioni anglisht. Për koordinimin e punëve të përkthimeve profesor Nuhiut t'i paguhet paushalli në vlerë prej 1.350.00 €; shqyrtoi kërkesën e znj. Fevzije Dautit (nr. 235, dt. 31.12.2012) dhe vendosi të refuzohet kërkesa në fjalë, meqë Ligji mbi shërbimin civil dhe Ligji i punës nuk parasheh kompensime të pagave dhe të shpërblimeve pas pensionimit.

2. Mbledhja (XIX) e Kryesisë, mbajtur më 31 janar u mor me shqyrtimin e të gjitha pikave të raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2012, duke filluar nga Kuvendi e deri te shërbimi administrativ, profesional e teknik dhe vendosi që raporti t'i përcillet Kuvendit të ASHAK-ut për miratim; miratoi raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2012; vendosi që mbledhja LXXIX e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 20 shkurt 2013, në orën 11:00 dhe propozoi rendin e ditës si në vijim: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXVIII të Kuvendit; shqyrtimi i raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2012; shqyrtimi i raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2012 dhe çështje vijuese; vendosi të ndryshojë përbërjen e Komisionit për amendamentimin e Ligjit për Akademinë dhe në vend të akademik Esat Stavilecit, anëtar i Komisionit në fjalë, u caktua anëtari korrespondent Arsim Bajrami; vendosi që në vendin e punës menaxher i prokurimit të rikthehet punonjësi z. Bedri Pllana, ndërsa për vendin e punës përgjegjës i Arkivit dhe depos u vendos të shpallet konkursi; ngriti Komisionin përzgjedhës për pranimin e punonjësit të ri në pozitën përgjegjës i Bibliotekës me këtë përbërje: akademik Eqrem Basha, kryetar, akademik Isuf Krasniqi, anëtar dhe znj. Lendita Pula, anëtare, si dhe Komisionin përzgjedhës për pozitën zyrtar i shpenzimeve/financiar, me këtë përbërje: akademik Isuf Krasniqi, znj. Lendita Pula dhe znj. Vjollca Hykolli; vendosi të ndahen 1.000 € për



dhënien e donacionit për mamograf mobil, si dhe në fund Kryesia shqyrtoi kërkesën e znj. Fevzije Dauti nr. 245 të datës 29.10.2012 për blerjen e banesës. Kërkesa në fjalë u miratua dhe u autorizua znj. Pula të merret me caktimin e ekspertit i cili do ta bëjë vlerësimin e banesës në fjalë.

3. Kryesia në mbledhjen e dt. 5 shkurt (XX) vendosi: të blihen pajisjet kompjuterike, meqë numri i anëtarëve të Akademisë është rritur dhe secili prej tyre ka nevojë të ketë kompjuter dhe pajisje të tjera përkatëse; të pajisen me tavolina dhe karrige sallat e seksioneve dhe të pajisen me dollapë dhe rafte disa kabinete të anëtarëve të Akademisë sipas nevojës; të vendosen podiumet në dy sallat e Akademisë; pjesëmarrësve të koncertit t'u paguhet paushallët përkatëse, vlera e të cilave do të përcaktohet me kontratën mbi veprën; që punonjësi z. Bedri Pllana, menaxher i prokurimit të marrë pjesë në trajnimin *Prokurimi publik dhe shfrytëzimi transparent i buxhetit*, që do të mbahet në Ohër (Republika e Maqedonisë) nga 8-11 shkurt 2013.

Njëherësh në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia miratoi kërkesën e Komisionit për blerjen e veprave artistike si më poshtë:

a) Engjëll F. Berisha, me titull "Medaloni i Prizrenit", vaj në pëlthurë, 72x83 cm, me çmim prej gjithsej 2.000 € .

b) Nusret Salihamixhiqi, me titull "Loja", vaj në pëlthurë, 83x78 cm, me çmim prej 1.500 €.

4. Në mbledhjen (XXI) e mbajtur më 28 mars Kryesia shqyrtoi Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. L. Pula njoftoi të pranishmit se Projektligji në fjalë është shqyrtuar në të gjitha seksionet. Ka pasur vërtetje e sugjerime, por në përgjithësi është përkrahur si i tillë.

Diskutuan M. Krasniqi, M. Kraja, P. Nushi, Z. Ballata dhe gjatë diskutimeve u dhanë edhe disa propozime dhe vërejtje të cilat, siç u tha, përfaqësuesit e Akademisë duhet t'i marrin parasysh gjatë punës së mëtejme në grupin punues; shqyrtoi raportin e Komisionit përzgjedhës lidhur me konkursin e shpallur për plotësimin e vendit të punës përgjegjës i njësishë së Bibliotekës (akademik Eqrem Basha, akademik Isuf Krasniqi dhe Lendita Pula) dhe raportin e Komisionit përzgjedhës lidhur me konkursin e shpallur për plotësimin e vendit të punës zyrtar për shpenzime/financiar (akademik Isuf Krasniqi, Lendita Pula dhe Vjollca Hykolli). Kryesia, duke përkrahur propozimet e komisioneve mori vendim që Hilmi Zogjani të pranohet në vendin e punës përgjegjës i Njësishë së Bibliotekës dhe Lirijeta Bunjaku të pranohet në vendin e punës zyrtar për shpenzime/financiar. Punën duhet ta fillojnë më 1 maj 2013; mori vendim për ngritjen e Redaksisë së Revistës "Studime" me këtë përbërje: akademik Rexhep Ismajli, kryeredaktor; prof. dr. Victor Friedman, anëtar; akademik Eqrem Basha, anëtar; prof. dr. Teuta Abrashi, anëtare akademik

Mehmet Kraja, anëtar dhe revistës “Studime shoqërore” me këtë përbërje: akademik Pajazit Nushi, kryeredaktor; prof. dr. Noel Malcolm, anëtar; anëtar korrespondent Anton K. Berishaj, anëtar; anëtar korrespondent Arsim Bajrami, anëtar; anëtar korrespondent Edi Shukriu, sekretare; anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, anëtar.

Kryesia në vazhdim miratoi:

raportin e punonjësit Bedri Pllana, menaxher i prokurimit për pjesëmarrjen në trajnimin Prokurimi publik dhe shfrytëzimi transparent i buxhetit në Ohër - Maqedoni prej 8-11 shkurt 2013; raportin e akademik Hivzi Islamit dhe anëtarit korrespondent Jusuf Bajraktarit për qëndrimin e tyre në Institutin e Historisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë më 24-25 shkurt 2013; raportin e akademik Rexhep Ismajlit për pjesëmarrjen e tij në Kuvendin vjetor të Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve në Salzburg prej 1-3 mars 2013; raportin e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami dhe znj. Lendita Pula për pjesëmarrjen e tyre në punëtorinë për hartimin e Projektligjit për ASHAK-un në Durrës më 2-4 mars 2013; raportin e akademik Hivzi Islamit dhe anëtarit korrespondent Jusuf Bajraktarit për qëndrimin e tyre (vazhdimin e punës) në Institutin e Historisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë më 7-9 mars 2013; raportin e znj. Lendita Pula, znj. Vjollca Hykolli, znj. Hasime Maliqi, znj. Dafina Kavaja, znj. Lidije

Kelmendi dhe znj. Valbona Olluri për qëndrimin e tyre në Tiranë, më 7-9 mars 2013 me rastin e shënimit të 8 marsit dhe raportin e anëtares korrespondente Edi Shukriu dhe znj. Lendita Pula për qëndrimin e tyre në Ulqin me rastin e promovimit të veprës “Gra të shquara shqiptare” në gjuhën malazeze të prof. Shukriut, më 15-17 mars 2013.

Kryesia po ashtu vendosi si në vazhdim: t’u paguhen honorarët për realizimin e Monografisë Kosova - versioni anglisht - edhe për vitin 2013 anëtarëve të Këshillit bashkërendues, secilit nga 1.000€, kryeredaktorëve, secilit nga 3.000€, redaktorëve, secilit nga 2.000€, redaktorëve të fushave përkatëse, secilit nga 600€; anëtarëve të Redaksisë Qendrore të Enciklopedisë t’u ngrihet paushalli mujor nga 150 € në 200€ nga 1. 4. 2013; pjesëmarrësve të tryezës shkencore Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike, t’u paguhet paushalli në vlerë prej 100 € për secilin prej tyre për paraqitjen e kumtesave; z. Zeni Ballazhit t’i paguhet paushalli në vlerë prej 1.200 € për dizajnimin grafik të veprës së plotë të akademik Ali Podrimjes; të bëhet sigurimi fizik i objektit të ASHAK-ut, si dhe shqyrtoi kërkesën e z. Hilmi Syla nr. 48 të datës 14. 2. 2013 për blerjen e banesës. Kërkesa në fjalë u miratua dhe u autorizua znj. Pula të merret me caktimin e ekspertit i cili do ta bëjë vlerësimin e banesës në fjalë.

5. Mbledhja (XXII) e Kryesisë e

mbajtur më 12 qershor : Kryesia shqyrtoi programin e punës së ASHAK-ut, për vitin 2014. Gjatë shqyrtimit të programit sipas radhës së seksioneve u bënë disa ndryshime. U tha që disa nga pikat e propozuara në Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe në Seksionin e Arteve të plotësohen me arsyetimet përkatëse, ndërsa te Seksioni i Shkencave të Natyrës u tha të hiqet propozimi për botimin e veprës “Pesticidet në mbrojtjen e integruar të bimëve”, botim i përbashkët i ASHAK dhe ASHSH i autorëve akademik Latif Susurit dhe prof. dr. Arben Myrtës, meqë autorët e njëjtë kanë një tjetër botim që është propozuar për programin e punës për vitin 2013, e që duhet të vazhdojë. U tha se programi i punës për vitin 2014 me plotësimet e lartshënuara do t'i dërgohet Kuvendit të Akademisë për miratim.

Më pas Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se propozimet preliminare që kanë arritur nga ASHSH për pikat e Protokollit 2013-2015 janë shqyrtuar nëpër seksione dhe pas shqyrtimit është hartuar edhe drafti nga ASHAK-u me propozimet si më poshtë:

1. Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërademik të gjuhës shqipe. Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHAK (SGJL) dhe ASHSH (SSHSHA, IGJL - QSA);

2. Konferencë shkencore ndër-kombëtare “F. S. Noli - gjeniu i kulturës

shqiptare të shekullit XX” (Me rastin e 50-vjetorit të vdekjes) - Tiranë, 2015;

3. Konferencë shkencore për studimet albanologjike, ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë 2014;

4. Konferencë shkencore “Lufta e Parë Botërore më 1914 dhe çështja shqiptare”, ASHAK (SSHSH, IHP) në bashkëpunim me ASHSH, Prishtinë 2014;

5. Tryezë shkencore “Arkeologjia në trojet shqiptare - sfidat dhe mundësitë”, ASHAK-ASHSH, Prishtinë 2014;

6. Projekti “Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë”, ASHAK (SSHN) dhe ASHSH (SSHNT, INEUM - UPT), 2013 e në vazhdim;

7. Hartimi i monografisë “Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve”, bazuar në studimin e Projektit “Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri” (2009 – 2013) ASHSH (SSHNT; FSHN - UT; UBT; QTTB, Vlorë, MBUMK) dhe ASHAK (SSHN), 2013 e në vazhdim;

8. Mbrëmje artistike me vepra muzikore, pamore dhe poetike të anëtarëve të ASHAK-ut, Tiranë, 2014;

9. Promovime veprash shkencore, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim;

10. Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim;

11. Ligjërata të ndërsjella të akademikëve, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim.

Kryetari Islami tha se pika 8 që ka të bëjë me aktivitetin e Seksionit të Arteve, sipas bisedave paraprake që kemi bërë me përfaqësues të ASHSH-së, ka mundësi të mos pranohet nga ana e tyre, me arsyetimin se ata, përkundër dëshirës, nuk kanë kushte dhe mundësi për realizimin e aktivitetit në fjalë.

Anëtarët e Kryesisë u pajtuan që mbledhja LXXX e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 3 korrik 2013 në orën 11:00 dhe propozuan rendin e ditës si në vijim: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXIX të Kuvendit; miratimi i programit të punës së ASHAK për vitin 2014; çështje vijuese.

Në vazhdim Kryesia mori vendim për vazhdimin e angazhimit të prof. dr. Nebi Cakës për punët në Qendrën Leksikografike Enciklopedike të ASHAK-ut; vendosi të paguhen paushallët për botimin e veprës së plotë të Ali Podrimjes, si: familjes së të ndjerit, përkatësisht të vesë tij në shumën 20,000.00€, redaktorit përgjegjës të Redaksisë 2.000.00€, anëtarëve të Redaksisë, secilit nga 1,500.00€, lektura dhe korrektura 1,600.00 €.

Po ashtu u diskutua për plotësimin e sistematizimit të vendeve të punës me pozitat: drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe Bibliotekar. Diskutuan H. Islami, M. Kraja, I. Krasniqi dhe pas diskutimeve Kryesia vendosi të plotësohet sistematizimi i vendeve të punës me pozitat në fjalë dhe

pas përfundimit të procedurave përkatëse të shpallen konkurset.

Njëherësh Kryesia ngriti Komisionin përzgjedhës për pranimin e punonjësit të ri në pozitën drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale me këtë përbërje: akademik Isuf Krasniqi, kryetar, Lendita Pula, sekretare e Akademisë, Vjollca Hykolli, drejtore financiare.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia u njoftua nga sekretarja e Akademisë për planin e shfrytëzimit të pushimeve vjetore; mori vendim t'u paguhen mbushjet telefonike punonjësve të rinj: Hilmi Zogjanit 30€ dhe Lirijeta Bunjakut 10€; miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare: raportin e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami dhe Lendita Pula për qëndrimin e tyre në Lubjanë me rastin e vizitës në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, më 14-16 prill 2013; raportin e akademik Nexhat Dacit për pjesëmarrjen e tij në 4th Danube Academies Conference (DAC) në Rumani më 9-10 prill, raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Berlin dhe pjesëmarrjen në Asamblenë e ALLEA-s më 28 prill - 5 maj 2013, raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Poloni nga 5-8 maj 2013, raportin e z. Hilmi Zogjanit, përgjegjës i Njesisë së Bibliotekës dhe znj. Lendita Pula për qëndrimin e tyre në Shkup, Maqedoni më 27-28 maj 2013; vendosi t'u paguhet paushalli në

vlerë prej 100 € pjesëmarrësve të Tryezës shkencore “Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe”.

Po ashtu Kryesia u njoftua lidhur me botimin e librit të akademik Rexhep Ferrit “Arkeologjia e mëngjesit”, me autor Gëzim Qendro, botim i Shtëpisë Botuese *Dituria*, që u përrua në mjediset e ASHAK.

Kryetari Islami njoftoi se teksti i librit në fjalë është kopjuar nga libri Rexhep Ferri *Monografi*, botim i ASHAK-ut, me autor të njëjtë.

U tha se me këtë rast është bërë shkelle dhe për të do të njoftohet edhe akademik Ferri.

Në fund u shqyrtua kërkesa e Seksionit të Arteve të ASHAK-ut lidhur me ngritjen e bustit të akademik Ali Podrimjes. U tha se Akademia në shtator të vitit të kaluar u ka drejtuar kërkesa të veçanta për çështjen në fjalë kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe ministrit të Ministrisë së Kulturës , por deri më tani nuk ka marrë përgjigje. U tha se Akademia e ka kryer punën e saj dhe se tani iu mbetet institucioneve përkatëse të merren me këtë çështje.

6. Kryesia në mbledhjen (XXIII) e dt. 23 korrik shqyrtoi raportin e Komisionit përzgjedhës lidhur me konkursin e shpallur për plotësimin e vendit të punës drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale (akademik Isuf Krasniqi, Lendita Pula dhe Vjollca Hykolli) i cili, ndër të tjera, ka konstatuar:

“Komisioni përzgjedhës në përbërje: akademik Isuf Krasniqi, znj. Lendita Pula dhe znj. Vjollca Hykolli ka udhëhequr procedurën për zbatimin e konkursit për plotësimin e vendit të punës drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe i parashtron Kryesisë së Akademisë raportin si në vijim:

- Konkursi është shpallur në gazetën “Koha ditore” më 2 korrik 2013;

- Brenda afatit 15-ditësh kanë konkurruar 5 kandidatë.

- Të pesë kandidatët (Valon Fetahu, Sali Hashani, Vehbi Neziri, Ali Caka dhe Ramush Zeka ) janë përzgjedhur në listën e ngushtë.

- Në testin me shkrim kanë marrë pjesë pesë kandidatët e sipërshtuar. Kandidati Sali Hashani nuk e ka kaluar testin me shkrim dhe nuk është ftuar në intervistë me gojë.

Nga testet me shkrim që kanë bërë kandidatët e tjerë dhe nga intervistat me ta ka rezultuar se kandidati Ali Caka është dalluar nga kandidatët e tjerë dhe mbi këtë bazë Komisioni përzgjedhës i propozon Kryesisë së Akademisë që ai të pranohet në punë në vendin e punës së drejtorit të Departamentit të Përkrahjes Profesionale.

Kryesia, duke përkrahur propozimin e Komisionit, mori vendim që Ali Caka të pranohet në vendin e punës drejtor i

Departamentit të Përkrahjes Profesionale.

Punën duhet ta fillojë më 1 shtator 2013.

Më pas u shqyrtua raporti gjashtëmuor (janar-qershor) i projektit "Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre". U tha se raporti është përgatitur mirë dhe janë sqaruar të gjitha detajet rreth punës së deritanishme. Diskutuan H. Islami dhe F. Krasniqi dhe pas diskutimeve Kryesia miratoi raportin në fjalë, si dhe mori vendim për t'ua paguar paushallët personave të angazhuar në projekt.

Kryesia gjithashtu mori vendim për caktimin e çmimit të kompletit Vepra e plotë e Ali Podrimjes në vlerë prej 45€ dhe miratoi raportet nga udhëtimet zyrtare si në vazhdim: raportin e akademik Pajazit Nushit, Isuf Krasniqit dhe Lendita Pulës për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë më 12-13 qershor 2013 me rastin e nënshkrimit të Protokollit të bashkëpunimit ASHSH-ASHAK 2013-2015, raportin e Hivzi Islamit, Rexhep Ismajlit dhe Eqrem Bashës për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave të Bullgarisë më 20-22 qershor 2013, raportin e Hilmi Zogjanit Lendita Pulës dhe Vjollca Hykollit për qëndrimin e tyre në Tiranë në Bibliotekën Kombëtare Shqiptare dhe në ASHSH më 24-25 qershor 2013, raportin e Hivzi Islamit, Pajazit Nushit, Rexhep Ismajlit dhe

Ali Aliut për qëndrimin e tyre në Akademinë Maqedone të Shkencave dhe të Arteve më 4 korrik 2013.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje u diskutua edhe lidhur me botimin e librit *Monografi* të Tahir Emrës. U tha se gjatë përgatitjes së librit janë bërë disa lëshime për të cilat duhet të njoftohet edhe autori. Sekretari i përgjithshëm, që njëherësh është edhe kryesues i këshillit redaktues të ASHAK-ut, u ngarkua të merret me çështjen në fjalë.

7. Në mbledhjen XXIV të saj mbajtur më 6 shtator Kryesia miratoi Deklaratën për mbrojtjen dhe rumbullakimin e bazave të shtetësisë së Republikës së Kosovës me këtë përmbajtje:

"Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është duke i ndjekur me brengosje ngjarjet e fundit në Republikën e Kosovës dhe, duke e konsideruar të papranueshme tendencën e vazhdueshme të shtetit të Serbisë për devijimin e zgjidhjeve të ofruara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, përfshirë përmes veprimeve të fundit në procesin e bisedimeve, dhe duke i ndjerë trysnitë e vazhdueshme të BE-së ndaj Kosovës për të kufizuar elementet e shtetësisë që kanë dalë nga vullneti i përfaqësuesve të popullit të Kosovës, paraqet këtë deklaratë:

1. ASHAK-u konsideron se shteti sovran dhe i pavarur i Kosovës është krijuar mbi bazën e të drejtës

legjitime që buron nga vullneti i popullit të saj për vetëvendosje;

2. ASHAK-u kërkon që të mos dëmtohen bazat e shtetësisë dhe të pavarësisë së Kosovës që kanë dalë nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës nga një proces i kompromisit ndërkombëtar;

3. ASHAK-u gjykon tendencën e Serbisë për të shkelur parimet që janë vendosur në themel të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

4. ASHAK-u kërkon nga institucionet e Republikës së Kosovës ta mbrojnë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës në tërë territorin e saj;

5. ASHAK-u tërheq vërejtjen për qëndrimet e njëanshme të Bashkësisë Ndërkombëtare gjatë bisedimeve me Serbinë karshi Kosovës;

6. ASHAK-u kërkon prej bashkësisë ndërkombëtare që të heqë dorë nga presionet e vazhdueshme ndaj Kosovës për bërjen e kompromiseve të reja, përfshirë këtu edhe çështjen e përdorimit të simboleve shtetërore, elemente këto që mund të dëmtojnë bazën e shtetit të Kosovës;

7. ASHAK-u rikujton se bazat e shtetit të Kosovës janë krijuar në bashkërenditje me të, andaj çdo tendencë për t'i dëmtuar ato do ta bënte përgjegjëse edhe bashkësinë ndërkombëtare;

8. ASHAK-u kërkon prej BE-së dhe Misionit të saj për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës të ndërmarrë veprime konkrete dhe

efikase për zbatimin dhe sundimin e ligjit në veriun e Kosovës;

9. ASHAK-u kërkon nga bashkësia ndërkombëtare që të mos përdorë standarde të dyfishta ndaj palëve në bisedime;

10. ASHAK-u shpreh indinjatë për standardet e një pjese të bashkësisë ndërkombëtare që në emër të së drejtave legjitime të popullatës serbe, të garantuara plotësisht me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të legjitimojë dhe legalizojë ndërhyrjet e pashembullta për raportet ndërkombëtare të shtetit të Serbisë në shtetin sovran dhe të pavarur të Kosovës;

11. ASHAK-u e konsideron të padrejtë, joparimor dhe të papranueshëm qëndrimin neutral të BE-së karshi statusit të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut të monitoruar nga BE-ja, 23 prej anëtarëve të së cilës bashkë me 80 shtete të botës tashmë e kanë njohur pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës;

12. ASHAK-u u bën thirrje serbëve të Kosovës ta respektojnë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të integrohen dhe të bëhen pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës, si rruga e vetme e qëndrueshme për realizimin e të drejtave të tyre;

13. ASHAK-u kërkon nga institucionet shtetërore të Republikës së Serbisë dhe të bashkësisë ndërkombëtare që të respektojnë të



drejtat të shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe të vendosin reciprocitetin si kusht për ndërtimin e raporteve të mira fqinjësore;

14. ASHAK-u kërkon nga BE-ja të angazhohet vazhdimisht për perspektivën evropiane për Kosovën dhe t'ia hapë derën integritetit të plotë të Kosovës dhe popullit të saj;

15. ASHAK-u konsideron se ruajtja dhe mbrojtja e parimeve të shtetit dhe të pavarësisë së Kosovës siguron stabilitet dhe paqe në Ballkan, ndërsa tërheq vërejtjen se lëndimi i mëtejshëm i elementëve të shtetësisë dhe të pavarësisë së Kosovës do të krijonte një precedent të rrezikshëm me mundësi reale për destabilitet rajonal;

16. ASHAK-u angazhohet me të gjitha potencialet e veta drejt konsolidimit të plotë të shtetit të Kosovës dhe integritetit euroatlantik;

17. ASHAK-u kërkon prej institucioneve shtetërore dhe subjekteve politike që të arrijnë unitet politik për mbrojtjen e Kushtetutës dhe të interesave shtetërore të Republikës së Kosovës.

Kryesia e ASHAK-ut

Prishtinë, 6. 9. 2013

Akademik Hivzi Islami, kryetar

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia mori vendim për mbajtjen e takimit për projektin Enciklopedia e Kosovës (Fjalori Enciklopedik) në Durrës nga data 19-22 shtator 2013

dhe pagesën e shpenzimeve të akomodimit, transportit, materialeve të punës, si dhe 20% të mëditjeve ditore për pjesëmarrësit e takimit.

Po ashtu u vendos edhe për pagimin e mbushjeve telefonike për z. Ali Caka, drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale, në vlerë prej 30€ nga 1. 10. 2013; pajisjen me mobile të disa mjediseve të Akademisë dhe përrurimin e Veprës së plotë të Ali Podrimjes në Tiranë. U tha se të gjitha shpenzimet rreth përrurimit në fjalë do të mbulohen nga ASHAK-u.

8. Në mbledhjen e saj (XXV) të datës 25 tetor Kryesia mbajti takim me delegacionin e Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Takimin e hapi H. Islami, i cili në fillim u uroi mirëseardhje kryetarit dhe sekretares së përgjithshme shkencore të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë dhe më pas prezantoi para tyre anëtarët e Kryesisë së Akademisë sonë.

Në fjalën e tij kryetari Islami tha se jemi të nderuar që sot në mesin tonë kemi akademikët nga Bullgaria, të cilët kanë ardhur të bisedojnë për jetësimin e Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet dy Akademive tona, të cilin e kemi nënshkruar më 13 qershor 2012. Delegacioni nga Akademia jonë para disa muajve ka qëndruar në Akademinë e Shkencave të Bullgarisë dhe ka biseduar rreth pikave të mundshme të bashkëpunimit dhe tani kryetari Vodenicharov me rastin e kësaj vizite ka sjellë një dokument në të cilin janë



propozuar disa pika për bashkëpunim. Ne tani të gjitha këto propozime do t'i kalojmë nëpër seksionet e Akademisë dhe më pas ato do të shqyrtohen edhe në Kryesi. Në vazhdim kryetari Islami tha se Akademia jonë është relativisht e re në krahasim me akademitë e tjera, por do të mundohemi të bashkëpunojmë me ato mundësi që kemi. Ai edhe një herë falënderoi delegacionin nga Akademia Bullgare për vizitën.

Kryetari Vodenicharov në fjalën e tij, pasi përshëndeti të pranishmit, tha se ndjehet mirë që ndodhet në mesin e akademikëve të Kosovës dhe se ka ardhur me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy akademive. Ai në vazhdim diskutoi për pikat e propozuara nga Akademia e Bullgarisë dhe tha se bashkëpunimi mund të fillojë pas miratimit të tyre edhe nga ana e ASHAK-ut. Ai më pas shkurtimisht foli për funksionimin e Akademisë së Shkencave të Bullgarisë dhe tha se gjatë ligjëratës që do të mbajë më pas lidhur me këtë temë do të flasë më gjerësisht.

9. Kryesia në mbledhjen e 6 nëntorit (XXVI) diskutoi për shkallën e realizimit të programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2013. U tha se Programi deri më tani është realizuar në shkallë të mirë dhe deri në fund të vitit pritet të realizohet në tërësi. Njëherësh u kërkua që disa pika të programit të punës të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Seksionit të Arteve të plotësohen me arsyetime përkatëse; shqyrtoi propozimin e Redaksisë

Qendrore të Enciklopedisë së Kosovës për caktimin e shkallës së honorarëve për redaktorët dhe anëtarët e redaksive të fushave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës dhe mori vendim që të paguhen honorarët si më poshtë:

- për redaktorët e fushave 500€;
- për anëtarët e redaksive të fushave 300€.

Po ashtu Kryesia miratoi raportet nga udhëtimet zyrtare si në vijim: raportin e H. Islamit, M. Krajës dhe L. Pulës për qëndrimin e tyre në Tiranë më 29-31 korrik 2013 në funksion të realizimit të projektit Fjalori enciklopedik i Kosovës; raportin e Hivzi Islamit dhe Jusuf Bajraktarit për qëndrimin e tyre në Tiranë më 3-4 shtator 2013; raportin e L. Pulës dhe D. Kavajës për qëndrimin e tyre në Durrës më 6-8 shtator 2013 me qëllim të përgatitjeve për trajnimin për Fjalorin enciklopedik të Kosovës; raportin e Hilmi Zogjanit, përgjegjës i Bibliotekës, nga vizita e tij në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë më 9-13 shtator 2013; raportin nga takimi i punës për Fjalorin enciklopedik të Kosovës në Durrës më 19-22 shtator 2013; raportin e Hivzi Islamit për qëndrimin e tij në Tiranë më 20-22 shtator 2013; raportin e M. Krajës dhe A. Aliut nga qëndrimi i tyre në Tiranë më 22-24 shtator 2013 me qëllim të përgatitjeve të nevojshme për promovimin e veprës së plotë të Ali Podrimjes; raportin e H. Zogjanit nga vizita e tij në Shoqatën e Botuesve Shqiptarë në Tiranë më

9 tetor me qëllim të përgatitjeve për panairin e librit Tirana 2013; raportin e Hivzi Islamit dhe Eqrem Bashës për qëndrimin e tyre në Shkup më 10 tetor 2013; raportin e A. Aliut, M. Krajës, R. Ismajlit dhe L. Pulës për qëndrimin e tyre në Tiranë më 9-11 tetor 2013 me rastin e promovimit të veprës së plotë të Ali Podrimjes; raportin e anëtares korrespondente Edi Shukriu për qëndrimin e saj në Vienë më 10-13 tetor 2013 me rastin e pjesëmarrjes në takimin e ICOMOS – Europa Juglindore; raportin e mr. sc. Ardian Golës për qëndrimin e tij në Podgoricë më 16-18 tetor 2013 me rastin pjesëmarrjes në Konferencën ndërkombëtare me titull: Young Scientists and Science in the Region. Z. Gola në Konferencë, në emër të ASHAK-ut, është paraqitur me temën Research practices in Kosova-Challenges in Humanities and Social Sciences; raportin e akademik R. Ismajlit për qëndrimin e tij në Zagreb më 23-27 tetor me rastin e pjesëmarrjes në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore The Image(s) of South-Eastern and East-Central Europe throughout History të organizuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Studimeve të Evropës Juglindore (AIESEE), Komiteti Nacional Kroat dhe Instituti i Shkencave Shoqërore Ivo Pilar; raportin e Hivzi Islamit dhe Jusuf Bajraktarit për qëndrimin e tyre në Tiranë më 29-31 tetor 2013.

Në vazhdim Kryesia diskutoi për Memorandumin e bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Bullgarisë, përkatësisht për

propozimet që i kanë hartuar ata. Kryetari Islami kërkoi nga sekretarët e seksioneve që propozimet në fjalë t'i diskutojnë në seksionet e tyre dhe mundësisht brenda 15 ditësh ato të definohen, ashtu që edhe nga ana e ASHAK-ut të kemi një draft ku do të përfshihen propozimet tona; mori vendim që promovimet e botimeve të Akademisë të bëhen dy herë gjatë vitit, në qershor dhe në dhjetor; mori vendim që z. Zija Bylykbashit t'i ndërpritet angazhimi në cilësinë e sekretarit të Enciklopedisë së Kosovës nga data 31. 12. 2013. Punët e sekretarit nga data 1. 1. 2014 do t'i kryejë administrata e Akademisë, përkatësisht Departamenti i Përkrahjes Profesionale; shqyrtoi kërkesën e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë lidhur me botimin e fjalësit të lematizuar dhe vendosi të bëhet botimi në numër të kufizuar kopjesh i fjalësit të lematizuar të numrit të parë të revistës "Përparimi", si dhe prof. dr. Nebih Cakës u vendos t'i paguhet paushalli në vlerë prej 500 €; mori vendim për pagesën e kuotës së anëtarësisë së ASHAK-ut në ALLEA në vlerë prej 640 €; vendosi që prof. dr. Lindita Rugova të angazhohet për mbajtjen e procesverbalit në mbledhjen e Këshillit Ndërademik për Gjuhën Shqipe dhe për angazhimin në fjalë asaj t'i bëhet kompensimi në vlerë prej 100 €; caktoi Komisionin për vlerësimin e ofertave me këtë përbërje: Isuf Krasniqi, kryetar, Ali Caka, anëtar dhe Burim Rexhepi, anëtar.

10. Në mbledhjen (XXVII) e mbajtur më 19 dhjetor Kryesia diskutoi lidhur me propozimet e seksioneve të Akademisë për bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Bullgarisë. U tha se propozimet në fjalë t'i dorëzohen sekretares së Akademisë dhe më pas ato të shqyrtohen nga Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar i ASHAK-ut.

Po ashtu u miratuan raportet nga udhëtimet zyrtare si në vijim: raportin e H. Zogjanit për pjesëmarrjen e tij në panairin e librit Tirana 2013 më 13-17 nëntor 2013; raportin e akademikëve Hivzi Islami, Eqrem Basha, Ali Aliu, Rexhep Ismajli dhe Mehmet Kraja për qëndrimin e tyre në Tiranë më 13-16 nëntor 2013; raportin e Lendita Pulës, Ali Cakës dhe Dafina Kavajës për pjesëmarrjen e tyre në trajnimin *Kostimi i politikave të reja në institucionet publike*, në Stamboll, më 20-23 nëntor 2013; raportin e Lendita Pulës, Vjollca Hykollit, Ali Cakës dhe Hilmi Zogjanit për qëndrimin e tyre në Tiranë më 20-22 dhjetor 2013, raportin e akademik Rexhep Ismajlit për qëndrimin e tij në Berlin më 18-21 nëntor 2013 me rastin e pjesëmarrjes në 10 th Anniversary of the Berlin Declaration, si dhe raportin e anëtarit korrespondent Salih Gashit për pjesëmarrjen e tij në takimin vjetor të grupit punues për shkencë dhe edukim të ALLEA-s në Dublin më 19-21 nëntor 2013.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje

Kryesia mori vendim që prof. dr. Nebi Cakës t'i vazhdohet angazhimi rreth punëve të Qendrës Leksikografike nga 1. 1. 2014 - 30. 6. 2014 dhe diskutoi rreth veprimtarisë botuese të Akademisë. U tha që Këshilli redaktues i Kryesisë së Akademisë (sekretari i përgjithshëm dhe sekretarët e seksioneve) të merret me çështjen e botimeve dhe vitin vijues të caktohet një kompani e cila do të bëjë dizajnimin e të gjitha botimeve të Akademisë, të cilat më pas do të miratohen nga Këshilli; mori vendim për botimin e Fjalësit të zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës; mori vendim për pranimin e donacionit nga kompania Eng Office, shpk, Gjilan në vlerë prej 3.000 €; shqyrtoi raportin e L. Pulës për shkeljet disiplinore të punonjësit Bedri Pllana, menaxher i prokurimit dhe u dakordua që të vazhdohet me procedurat e parapara me Ligj dhe me akte të tjera normative në fuqi; mori vendim që z. Ali Caka, i sistemuar në pozitën drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale t'i caktohet shtesa profesionale në vlerë prej 400 €; mori vendim mbi shpenzimet telefonike për drejtuesit dhe punonjësit e ASHAK-ut për vitin 2014.

Njëherësh u diskutua edhe lidhur më prononcimin e akademik Fejzullah Krasniqit në takimin e mbajtur në Kolegjin privat Tempulli, me ç'rast në emër të ASHAK-ut akademik Krasniqi është shprehur i gatshëm për bashkëpunim me kolegjin në fjalë. U tha se prononcimi i

paautorizuar i akademik Krasniqit i ka bërë dëm Akademisë, duke e lënduar imazhin e saj. Kryesia tërhoqi vërejtjen se nuk bën të përsëriten veprimet e tilla nga askush.

### III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

#### *Projekte*

1. Versioni anglisht i monografisë “Kosova” – projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Pas përgatitjes së botimit në gjuhën shqipe në vitin 2011, Akademia ka ideuar botimin e një versioni të shkurtuar të monografisë “Kosova” në gjuhën angleze. Për këtë qëllim të gjithë autorët e teksteve kanë rimarrë në shqyrtim tekste të tyre, në mënyrë që ato të kondensohen në përmbajtje dhe të evitohen gabimet eventuale. Pas kësaj ka filluar procesi i redaktimit të këtyre versioneve në gjuhën shqipe, pastaj është bërë përkthimi në gjuhën angleze dhe, së fundi, është bërë redaktimi i përgjithshëm dhe gjuhësor i teksteve në gjuhën angleze. Botimi i versionit anglisht i monografisë “Kosova” u realizua në gjysmën e parë të vitit 2013.

2. Fjalori enciklopedik i Kosovës (projekt afatmesëm) është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Gjatë vitit 2013 është përfunduar fjalësi i zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës dhe me këtë është finalizuar faza e parë e këtij projekti. Redaksitë e fushave kanë hartuar nga disa versione të

fjalësit, ndërsa Redaksia Qendrore gjatë këtij viti, në më shumë se 30 mbledhje, ka shqyrtuar fjalësit e 24 fushave veç e veç, duke bërë korrigjime dhe sugjerime të shumta. Shqyrtimet e para të fjalësve të fushave janë mbajtur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 në prani të redaktorit të fushave, ndërsa shqyrtimet përfundimtare janë mbajtur gjatë muajve të fundit të vitit 2013 në të cilat janë harmonizuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet. Ndërmjet dy shqyrtimeve të fjalësit të plotë të zërave nga Redaksia Qendrore, pasi u hartua versioni i parë i fjalësit, në shtator u mbajt një takim i përbashkët tredit i Bordit, Redaksisë Qendrore dhe redaktorëve të fushave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës në të cilin u shqyrtuan fjalësi alfabetik dhe fjalësit sipas fushave. Me këtë rast u diskutuan të gjitha problemet rreth përfshirjes së lëndës enciklopedike në Fjalor, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për metodologjinë e hartimit të Fjalorit. Fjalësi i përfundimtar i Fjalorit enciklopedik të Kosovës (versioni i katërt) përfshin rreth 5900 zëra.

3. Këshilli Ndërad akademik për Gjuhën Shqipe (projekt afatgjatë) gjatë vitit 2013 ka vazhduar punën e rinisur. Sipas marrëveshjes me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, kryesimin e Këshillit gjatë kësaj periudhe e ka pasur ASHAK-u dhe kjo ka bërë që puna e filluar të intensifikohet. Gjatë vitit 2013 Këshilli ka qenë i përqendruar në dy fusha kryesore të standardit të gjuhës shqipe, në drejtshkrim dhe morfologji. Komisionet përkatëse të këtyre dy

fushave kanë hartuar materialet bazë, të cilat më pastaj janë shqyrtuar dhe janë miratuar nga Këshilli. Edhe përkundër kundërshtive dhe polemikave të herëpashershme, Këshilli ka arritur të bëjë publike propozimet për disa ndryshime në fushën e drejtshkrimit dhe morfologjisë.

4. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX (projekt afatgjatë) gjatë vitit 2013 ka vazhduar realizimi i këtij projekti me të cilin synohet studimi i tërësisë së zhvillimeve gjuhësore në Kosovë gjatë shekullit XX. Ashtu sikundër është paraparë me fazën e parë të projektit, tashmë ka filluar krijimi i bazës së të dhënave elektronike ku do të përfshihen trajtat specifike të leksikut dhe tipologjitë e fjalëformimit, si dhe trajtat e veçanta të zgjedhimit dhe fleksionit në shqipen e shkruar të Kosovës. Deri më tani është aktivizuar një njësi pilot për skanimin dhe digjitalizimin e dokumenteve, janë siguruar 230 numra të revistës “Përparimi” të periudhës 1955-1991 dhe janë skanuar ato, si dhe është hartuar lista gjithëpërfshirëse e numrave të skanuar. Janë siguruar gjithashtu edhe të gjithë numrat e revistës “Jeta e re” nga viti 1949-1968 dhe janë bërë gati për skanim.

5. Vepra e plotë e Norbert Joklit – botimi i plotë i veprës së Norbert Joklit është projekt afatmesëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i cili tashmë gjendet në fazën e realizimit përfundimtar. Pas botimit të suksesshëm të librit të parë, ka vazhduar puna për përgatitjen për botim edhe të vëllimit II dhe III. Gjatë vitit 2013 ka

vazhduar përgatitja për botim e vëllimit të dytë të studimeve të Joklit: *Linguistische-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen* (Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes) i botuar më 1923. Përkthimi në shqip është bërë nga Anton Krajni në vitet '50 të shekullit XX në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer shpesh ka mungesa pjesësh, prandaj është paraqitur nevoja të bëhet krahasimi i plotë me origjinalin. Përgatitja për shtyp e vëllimit të dytë mund të pritët gjatë vitit 2014, ndërsa vëllimi III ende gjendet në procesin e përkthimit.

#### *Konferenca dhe tryeza shkencore*

1. Tryeza shkencore “Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike” është mbajtur më 7 qershor 2013 dhe ka marrë në shqyrtim një çështje me interes edhe për punën në vazhdim rreth Fjalorit enciklopedik dhe Enciklopedisë së Kosovës. Në këtë tryezë shkencore, e cila i ka zhvilluar punimet në dy seanca, me kumtesat e tyre janë prezantuar 18 studiues nga Kosova, nga Shqipëria dhe Maqedonia. Kumtesat e paraqitura janë përgatitur për botim në numrin vijues të revistës “Studime”.

2. Tryeza shkencore “Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe” është mbajtur më 27 qershor 2013 me pjesëmarrjen e studiuesve që merren me këtë fushë të gjuhësisë. Në shqyrtimin e temës së shtruar, me kumtesa dhe trajtesa shkencore janë paraqitur 17 studiues nga Kosova dhe Shqipëria. Po me këtë rast

është bërë edhe paraqitja e veprës së Vesel Nuhiut, “Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe”, botim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Kontributet e paraqitura në tryezën shkencore janë përgatitur për botim në numrin vijues të revistës “Studime”.

### *Botime*

1. Vepra e plotë e Ali Podrimjes, ndonëse nuk ishte në programin e punës së Seksionit për vitin 2013, pas vdekjes së poetit, me mbështetjen e plotë të Akademisë dhe të strukturave buxhetore, u bë e mundur të realizohet botimi i plotë i veprave të Ali Podrimjes. Për këtë qëllim, në kuadër të Seksionit, u formua redaksia e botimit në përbërje të së cilës u caktuan akademikët Ali Aliu (redaktor), Rexhep Ismajli, Eqrem Basha, Sabri Hamiti dhe Mehmet Kraja. Kjo redaksi vendosi që vepra e plotë e Ali Podrimjes të përfshijë të gjithë krijimtarinë e botuar të poetit, duke përfillur kronologjinë e botimeve të realizuara në gjallje të autorit. Kështu, vepra e plotë e Podrimjes përfshin poezinë në gjashtë vëllime, ndërsa në tre vëllime është botuar proza dhe publicistika. Secili vëllim me poezi shoqërohet me nga një parathënie - studim nga autorë të ndryshëm.

2. Vesel Nuhii: “Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe”, libri është një studim monografik i përqendruar në fushën e studimit të huazimeve gjuhësore. Duke qenë i pari i këtij lloji te ne, me botimin e këtij libri Akademia ka bërë një punë të çmuar, duke plotësuar një zbrazëti që është ndjerë

në këtë fushë të studimeve. Në këtë vepër janë përfshirë shqyrtime të ndryshme për ndikimet e gjuhës angleze në shqipen e Ballkanit dhe në shqipen e shqiptarëve të Amerikës.

3. Sabri Hamiti: “Utopia letrare”, i paraparë me programin e punës të vitit 2012, është përgatitur për shtyp dhe është botuar gjatë vitit 2013. Bëhet fjalë për një vepër studimore, e cila është vazhdimësi e studimeve të letërsisë shqipe bërë po nga ky autor në librat e tij pararendës. Me trajtimin origjinal, me metodologjinë e avancuar të studimit dhe me mbështetjen e qëndrueshme teorike të disa postulateve themelore të artit të shkrimit letrar, vepra ka zgjuar interesimin e studiuesve të letërsisë.

4. Revista “Studime” nr. 1 (20). - Gjatë vitit të shkuar janë grumbulluar materialet për botimin e numrit vijues të revistës. Në këtë numër të revistës, përveç studimeve dhe trajtesave të veçanta, janë përfshirë edhe kumtesat dhe referatet nga dy tryezat shkencore të organizuara nga Seksioni, ajo për letërsinë në shkrimet enciklopedike dhe për anglicizmat në gjuhën shqipe.

### *Promovime*

Pas daljes nga shtypi, veprës së plotë të Podrimjes iu bë promovim në Prishtinë dhe Tiranë.

### *Ligjërata*

Ligjëratë inauguruese e akademik Kolec Topallit. - Me rastin e pranimit anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,

akademik Kolec Topalli ka mbajtur ligjëraten inauguruese me titull "Disa rezultate në studimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe".

Sekretari i Seksionit

Akademik Mehmet Kraja d.v.

#### IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

##### *Projekte*

1. Versioni anglisht i monografisë "Kosova". – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Pas përgatitjes së botimit në gjuhën shqipe në vitin 2011, Akademia ka ideuar botimin e një versioni të shkurtuar të monografisë "Kosova" në gjuhën angleze. Për këtë qëllim të gjithë autorët e teksteve kanë rimarrë në shqyrtim tekstet e tyre, në mënyrë që ato të kondensohen në përmbajtje dhe të evitohen gabimet eventuale. Pas kësaj ka filluar procesi i redaktimit të këtyre versioneve në gjuhën shqipe, pastaj është bërë përkthimi në gjuhën angleze dhe, së fundi është bërë redaktimi i përgjithshëm dhe gjuhësor e teksteve në gjuhën angleze. Botimi i versionit anglisht i monografisë "Kosova" u realizua në gjysmën e parë të vitit 2013.

2. Fjalori enciklopedik i Kosovës (projekt afatmesëm). – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Gjatë vitit 2013 është përfunduar fjalësi i zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës dhe me këtë është

finalizuar faza e parë e këtij projekti. Redaksitë e fushave kanë hartuar nga disa versione të fjalësit, ndërsa Redaksia Qendrore gjatë këtij viti, në më shumë se 30 mbledhje, ka shqyrtuar fjalësit e 24 fushave veç e veç, duke bërë korrigjime dhe sugjerime të shumta. Shqyrtimet e para të fjalësve të fushave janë mbajtur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 në prani të redaktorit të fushave, ndërsa shqyrtimet përfundimtare janë mbajtur gjatë muajve të fundit të vitit 2013 në të cilat janë harmonizuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet. Ndërmjet dy shqyrtimeve të fjalësit të plotë të zërave nga Redaksia Qendrore, pasi u hartua versioni i parë i fjalësit, në shtator u mbajt një takim i përbashkët tredit i Bordit, Redaksisë Qendrore dhe redaktorëve të fushave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës, në të cilin u shqyrtuan fjalësi alfabetik dhe fjalësit sipas e fushave. Me këtë rast u diskutuan të gjitha problemet rreth përfshirjes së lëndës enciklopedike në Fjalor dhe çështjet e tjera me rëndësi për metodologjinë e hartimit të tij. Fjalësi përfundimtar i Fjalorit enciklopedik të Kosovës (versioni i katërt) përfshin rreth 5900 zëra.

##### *Konferenca dhe tryeza shkencore*

1. "Perspektivat e komplementarititetit në zhvillimin ekonomik ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe regjionit".

Tryeza nuk është mbajtur.



2. "Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integruës të Kosovës".

Tryeza u mbajt më 27 dhjetor 2013 në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë.

Tryezën e hapi akademik Mark Krasniqi, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore, ndërsa të pranishmit i përshëndeti edhe akademik Isa Mustafa, anëtar i këtij Seksioni dhe organizator i tryezës. Kontributet e tryezës do të botohen në numrin I të revistës "Studime shoqërore".

#### *Botime*

1. Pajazit Nushi: "Mendimi psikologjik popullor dhe gjeneza e të menduarit shkencor psikologjik të shqipfolësit"

Duke qenë se vepra "Leksikon i Psikologjisë" që është në përfundim, është shumë voluminoze (vëllimi I dhe II) dhe më e rëndësishme, autori heq dorë nga vepra "Mendimi psikologjik popullor dhe gjeneza e të menduarit shkencor psikologjik të shqipfolësit", me qëllim që t'i përkushtohet përfundimit të veprës "Leksikon i Psikologjisë".

2. Esat Stavileci: "Të menduarit dhe të shkruarit juridik".

Libri ka dalë nga shtypi.

Në libër është trajtuar të menduarit dhe të shkruarit përgjithësisht dhe të

menduarit e të shkruarit në mënyrë të veçantë, që pa dyshim paraqet një fushë me shumë interes. Njëkohësisht libri shtrihet edhe në njohuritë e përgjithshme nga fusha e metodologjisë së hulumtimit shkencor.

3. Dr. Arsim Ejupi: "Lugina e Preshevës – studim kompleks gjeohapësinor".

Libri ka dalë nga shtypi.

Është një botim i rrallë dhe me veçori specifike. Libri ka një përmbajtje komplekse gjeohapësinore e gjepolitike dhe qasje teoriko-metodologjike dhe empirike. Është hartuar për herë të parë dhe si botim vjen në kohën më të duhur, kur vëmendja ndaj çështjes së Luginës po rritet në të gjitha nivelet e zhvillimeve politike shqiptare dhe evropiane.

4. Dr. Jusuf Osmani dhe dr. Ramë Manaj: "Ndarja administrative – territoriale e Kosovës 1944 2010" (dokumente).

Libri pritet të dalë së shpejti nga shtypi.

5. Grup autorësh: "Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë 2000 - 2012".

Kanë përfunduar të gjitha punët rreth përgatitjes së librit dhe pritet botimi i tij.

6. Revista "Studime shoqërore" është në përgatitje e sipër dhe pritet së shpejti të shkojë në shtyp.

#### *Promovime*

Nga Seksioni janë promovuar këto vepra:



1. "Të menduarit dhe të shkruarit juridik" i Esat Stavilecit;

2. "Lugina e Preshevës - studim kompleks gjeohapësinor" i dr. Arsim Ejupit.

### *Ligjërata*

1. Gjatë vitit është mbajtur ligjërata inauguruese e anëtarit korrespondent Arsim Bajrami me titull:

“Argumentimi kushtetues juridik i pavarësisë së Kosovës dhe vendimi i GjND-së”.

### *Njoftim*

Dy anëtarë të Seksionit akademik Hivzi Islami dhe anëtare korrespondente Edi Shukriu janë pranuar anëtarë të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve (EASA) me seli në Strazburg

Sekretari i Seksionit

Akademik Mark Krasniqi d.v.

## **V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS**

Gjatë vitit 2013 Seksioni i Shkencave të Natyrës ka punuar sipas Programit të punës të propozuar dhe të aprovuar nga Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Veprimtaria e Seksionit është mbështetur edhe në Protokollin e bashkëpunimit në mes të ASHAK dhe ASHSH.

Me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve për realizimin e programit, Seksioni ka mbajtur disa mbledhje, në të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar problemet dhe veprimtaritë që i përkasin këtij Seksioni. Njëherësh është analizuar shkalla e realizimit të programit, si dhe janë propozuar veprimtari të tjera shkencore që do të parashihen edhe në programin e punës për vitin vijues.

Në mbledhjet e Seksionit të SHN rregullisht kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e Seksionit, me përjashtim kur ndonjëri ka munguar me arsye. Kështu, qëndrimet dhe vendimet e Seksionit janë marrë duke qenë të pranishëm të gjithë ose shumica absolute e anëtarëve të Seksionit.

### *Projekte*

1. Versioni anglisht i monografisë “Kosova” – projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Pas përgatitjes së botimit në gjuhën shqipe në vitin 2011, Akademia ka ideuar botimin e një versioni të shkurtuar të monografisë “Kosova” në gjuhën angleze. Për këtë qëllim të gjithë autorët e teksteve kanë rimarrë në shqyrtim tekstet e tyre, në mënyrë që ato të kondensohen në përmbajtje dhe të evitohen gabimet eventuale. Pas kësaj ka filluar procesi i redaktimit të këtyre versioneve në gjuhën shqipe, pastaj është bërë përkthimi në gjuhën angleze dhe, së fundi, është bërë redaktimi i përgjithshëm dhe gjuhësor i teksteve në gjuhën

angleze. Botimi i versionit anglisht i monografisë “Kosova” u realizua në gjysmën e parë të vitit 2013.

2. Fjalori enciklopedik i Kosovës (projekt afatmesëm). – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Gjatë vitit 2013 është përfunduar fjalësi i zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës dhe me këtë është finalizuar faza e parë e këtij projekti. Redaksitë e fushave kanë hartuar nga disa versione të fjalësit, ndërsa Redaksia Qendrore gjatë këtij viti, në më shumë se 30 mbledhje, ka shqyrtuar fjalësit e 24 fushave veç e veç, duke bërë korrigjime dhe sugjerime të shumta. Shqyrtimet e para të fjalësve të fushave janë mbajtur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 në prani të redaktorit të fushave, ndërsa shqyrtimet përfundimtare janë mbajtur gjatë muajve të fundit të vitit 2013, në të cilat janë harmonizuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet. Ndërmjet dy shqyrtimeve të fjalësit të plotë të zërave nga Redaksia Qendrore, pasi u hartua versioni i parë i fjalësit, në shtator u mbajt një takim i përbashkët tredit i Bordit, Redaksisë Qendrore dhe redaktorëve të fushave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës në të cilin u shqyrtuan fjalësi alfabetik dhe fjalësit sipas fushave. Me këtë rast u diskutuan të gjitha problemet rreth përfshirjes së lëndës enciklopedike në Fjalor, si dhe çështjet tjera me rëndësi për metodologjinë e hartimit të Fjalorit. Fjalësi përfundimtar i Fjalorit

Enciklopedik të Kosovës (versioni i katërt) përfshin rreth 5900 zëra.

3. “Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë ”ASHAK (SSHNT) në bashkëpunim me ASHSH (SSHNT, INEUM - UPT). - Ky projekt ishte i paraparë me protokollin 2011-2013 me ASHSH. Meqë pati ngecje në kryerjen e punëve që pasuan edhe me disa ndryshime të grupeve punuese nga pala e ASHSH-ut, ky projekt është përfshirë edhe në protokollin e bashkëpunimit 2013-2015. Shumica e punëve të planifikuara lidhur me këtë projekt janë kryer nga pala e ASHAK-ut. Duke qenë se projekti është punë e përbashkët e dy Akademive, tani edhe pjesa e projektit e cila ka të bëjë me Shqipërinë është në fazën e punës dhe e ajo pritët të realizohet brenda afateve të përcaktuara me këtë Protokoll.

4. “Bimët e rrezikuara e të rralla të florës së Kosovës”.

Ky projekt i takon fushës së mjedisit dhe është me karakter hulumtues shkencor. Ndikimi i faktorit njeri në florën dhe vegjetacionin, përkatësisht në biodiversitetin e përgjithshëm autokton është shumë i madh, madje me pasoja negative për mjedisin, prandaj është propozuar projekti në fjalë. Realizimin e këtij projekti është dashur ta bëjë ekipi hulumtues kryesisht nga kuadri i Departamentit të Biologjisë të FSHMN-së në koordinim me anëtarët përkatës të ASHAK-ut, i themeluar që në fillim të vitit 2011, kur edhe është miratuar projekti. Në mungesë të kushteve për punë në projekte të

kësaj natyre (mungesa e automjeteve dhe pajisjeve tjera për hulumtime në terren, mjeteve relativisht të mëdha financiare për kushtet tona, etj.) në projekt nuk është punuar gjatë viteve 2011 dhe 2012. Kështu, projekti është bartur në vitin 2013. Gjatë këtij viti ka filluar puna nga disa anëtarë të ekipit hulumtues në mbledhjen dhe studimin e bimëve të rrezikuara dhe të rralla në Kosovë. Kjo pjesë e ekipit hulumtues e ka paraqitur një raport për punën e kryer lidhur me këtë projekt. Puna e gjertanishme është kryer me vetiniciativë të kësaj pjese të ekipit hulumtues dhe e njëjta është bërë pa asnjë mbulesë të shpenzimeve të krijuara.

Duke pasur parasysh se shumica e anëtarëve të ekipit hulumtues nuk kanë treguar vullnetin dhe dëshirën për një punë ekipore të përbashkët, e cila është kusht për finalizimin e suksesshëm të këtij projekti, propozohet që ky projekt tani për tani të hiqet nga programi i punës të Seksionit të Shkencave të Natyrës si pasojë e mungesës së kushteve dhe mjeteve financiare në fillim dhe të shpërbërjes së ekipit hulumtues në ndërkohë.

5. "Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë si dhe trajtimi i tyre".

Ky projekt për nga subjekti i takon kimisë së mjedisit me karakter hulumtues dhe aplikativ. Projekti ka për qëllim identifikimin e ndotësve të ujërave sipas standardeve shkencore që përdoren në tërë botën për këtë qëllim. Në realizimin e projektit marrin

pjesë ASHAK – Seksioni i Shkencave të Natyrës dhe Universiteti i Prishtinës, FSHMN – Departamenti i Kimisë.

Më 16 korrik 2013 Seksioni i SHN e ka miratuar raportin e parë të punës 6-mujore (janar-qershor) të vitit 2013 i cili është paraqitur nga udhëheqësi i projektit akademik Nexhat Daci.

Më 17 dhjetor 2013 Seksioni i SHN e ka aprovuar raportin njëvjetor të punës në këtë projekt për vitin 2013 i cili po ashtu është paraqitur nga udhëheqësi i projektit akademik Nexhat Daci. Projekti vazhdon të realizohet edhe gjatë vitit 2014, meqë i ai sipas planit zgjatë 2 vjet.

Pas shqyrtimit të raportit të punës së Seksionit të Shkencave të Natyrës nga Kryesia e Akademisë (më 31. 1. 2014), për punët rreth projektit në fjalë u kërkua edhe një raport i veçantë për periudhën gjashtëmujore (korrik - dhjetor 2013).

6. "Ndikimi i mbitensioneve atmosferike në sistemet elektroenergjetike të Kosovës".

Projekti ka filluar të realizohet në vitin 2012. Me qëllim të grumbullimit të sa më shumë të dhënave për frekuencën e zbrazjeve të rrufeve në territorin e Kosovës, nga udhëheqësi i projektit akademik Isuf Krasniqi është propozuar zgjatja e afatit të tij edhe për një vit. Për këtë qëllim është propozuar që projekti të vazhdojë me punë edhe në vitin 2014.

7. "Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe në Shqipëri".

Ky projekt është realizuar bashkë me ASHSH-në sipas Protokollit të bashkëpunimit shkencor ndërmjet të dy Akademive për periudhën 2011-2013. Koordinator i projektit nga ASHAK ishte akademik Latif Susuri, ndërsa nga ASHSH ishte akad. asoc. Efigjeni Kongjika. Raporti përfundimtar i punës lidhur me këtë projekt është miratuar në mbledhjen e Seksionit të Shkencave të Natyrës më 17 dhjetor 2013.

### *Botime*

1. Akademik Nexhat Daci: "Mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm".

Titulli i botimit e edhe përmbajtja e kapitujve janë vetëm punues dhe gjatë trajtimit të tyre mund të pasojnë edhe plotësime të tjera si dhe mund të ketë koautorë të botimit. Në këtë vepër është duke u punuar intensivisht. Meqë është vepër mjaft komplekse dhe shumë-dimensionale, botimi i saj shtyhet për vitin 2014.

2. Akademik Fejzullah Krasniqi: "Termocentralet e Kosovës".

Në këtë vepër është duke u punuar në mënyrë sistematike gjatë tërë vitit 2013. Meqë gjatë punës është shprehur nevoja edhe për disa analiza dhe hulumtime shkencore shtesë, kompletimi i plotë dhe botimi i kësaj vepre është shtyrë për vitin 2014.

3. Revista "Kërkime".

Numri 20 i Revistës shkencore "Kërkime" është botuar sipas planit të punës për vitin 2013 dhe tani është duke u punuar në përgatitjen e numrit vijues 21.

### *Konferenca shkencore*

1. "Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm".

Përgatitja e programit dhe agjendës së konferencës me titull „Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm” është bërë nëpërmjet një procesi të bashkëpunimit dhe bashkërendimit, si dhe të kontakteve direkte ndërmjet Këshillit shkencor-organizativ (Nexhat Daci, kryetar, Isuf Krasniqi dhe Fejzullah Krasniqi, anëtarë) me ekspertë dhe drejtues të niveleve të ndryshme të institucioneve dhe subjekteve përgjegjëse dhe pjesëmarrëse në veprimtaritë e sektorit energjetik. Përgatitjen dhe organizimin e Konferencës e kanë ndihmuar edhe të gjithë anëtarët e Seksionit të Shkencave të Natyrës. Konferenca është mbajtur në mjediset e Akademisë më 30 tetor 2013 me pjesëmarrje dhe kontribute të mëdha të ekspertëve dhe studiuesve të lëmit të energjetikës nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe të një përfaqësuesi nga Anglia.

Këshilli i konferencës shpreh falënderim dhe mirënjohje për udhëheqjen e Akademisë për përkrahje të plotë për organizimin dhe përfundimin e suksesshëm të konferencës. Këshilli gjithashtu falënderon edhe për përkrahjen teknike nga personeli përkatës i ASHAK-ut që nga faza e përgatitjes e deri në përfundimin e konferencës.

### *Ligjërata*

Gjatë vitit 2013 (më 4. 6. 2013) është mbajtur ligjërata inauguruese e anëtarit korrespondent Ruzhdi Pllana me titull:

“Karakteristikat morfohidrologjike të karstit të Kosovës”.

### *Promovime*

Promovime të veprave të anëtarëve të Akademisë nuk ka pasur.

Sekretari i Seksionit

Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

## **VI. SEKSIONI I ARTEVE**

Seksioni i Arteve i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në kuadër të Planit të punës për vitin kalendarik 2013 të propozuar nga anëtarët e Seksionit dhe të miratuar po nga Seksioni i Arteve ka mbajtur gjatë vitit 2013 gjithsej 9 mbledhje të Seksionit. Në mbledhjet e Seksionit kanë qenë të pranishëm, pothuaj rregullisht, të gjithë anëtarët e Seksionit, me përjashtim të ndonjë rasti kur ndonjëri nga anëtarët kanë munguar me arsye. Së këndejmi, qëndrimet dhe vendimet e Seksionit janë marrë duke qenë të pranishëm të gjithë ose shumica absolute e anëtarëve të Seksionit.

### *Projekte*

1. Versioni anglisht i monografisë “Kosova” – projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Pas përgatitjes së botimit në gjuhën shqipe në vitin 2011, Akademia ka ideuar botimin e një versioni të shkurtuar të monografisë “Kosova” në gjuhën angleze. Për këtë qëllim, të gjithë autorët e teksteve kanë rimarrë në shqyrtim tekstat e tyre, në mënyrë që

ato të kondensohen në përmbajtje dhe të evitohen gabimet eventuale. Pas kësaj ka filluar procesi i redaktimit të këtyre versioneve në gjuhën shqipe, pastaj është bërë përkthimi në gjuhën angleze dhe, së fundi, është bërë redaktura e përgjithshme dhe gjuhësore e teksteve në gjuhën angleze. Botimi i versionit anglisht i monografisë “Kosova” u realizua në gjysmën e parë të vitit 2013.

2. Fjalori enciklopedik i Kosovës (projekt afatmesëm) – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Gjatë vitit 2013 është përfunduar fjalësi i zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës dhe me këtë është finalizuar faza e parë e këtij projekti. Redaksitë e fushave shkencore kanë hartuar nga disa versione të fjalësit, ndërsa Redaksia Qendrore gjatë këtij viti, në më shumë se 30 mbledhje, ka shqyrtuar fjalësit e 24 fushave veç e veç, duke bërë korrigjime dhe sugjerime të shumta. Shqyrtimet e para të fjalësve të fushave janë mbajtur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 në prani të redaktorit të fushave, ndërsa shqyrtimet përfundimtare janë mbajtur gjatë muajve të fundit të vitit 2013, në të cilat janë harmonizuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet. Ndërmjet dy shqyrtimeve të fjalësit të plotë të zërave nga Redaksia Qendrore, pasi u hartua versioni i parë i fjalësit, në shtator u mbajt një takim i përbashkët treditör i Bordit, Redaksisë Qendrore dhe redaktorëve të fushave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës, në të cilin u shqyrtuan fjalësi alfabetik dhe fjalësit sipas e fushave shkencore.

Me këtë rast u diskutuan të gjitha problemet rreth përfshirjes së lëndës enciklopedike në Fjalor, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për metodologjinë e hartimit të Fjalorit. Fjalësi përfundimtar i Fjalorit enciklopedik të Kosovë s (versioni i katërt) përfshin rreth 5900 zëra.

### *Koncerte*

Kushtuar 5-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, më 15 shkurt 2013, në mjediset e ASHAK-ut, u organizua koncerti solemn, në të cilin morën pjesë akademikë, pedagogë e studentë të artit, personalitete të shquara të muzikës nga Shqipëria, si Avni Mula dhe Zhani Ciko si dhe interpretë dhe instrumentistë të shquar.

### *Ekspozita*

1. Për ekspozitën e akad. Tahir Emrës, e cila do ta përfshijë një periudhë 50-vjeçare të krijimtarisë së autorit, vetë autori ka kërkuar që t'i mundësohet një afat paksa më i gjatë për përgatitjen e kësaj ekspozite. U tha që ekspozita do të realizohet deri në gjysmën e parë të vitit 2014.

### *Botime*

1. Tahir Emra, monografi, libri është botuar.

2. Rauf Dhomi: "Uvertura solemne". - Libri ka dalë nga shtypi.

Vepra në fjalë - partitura e saj, është botuar bashkë edhe me partet e instrumenteve veç e veç dhe

përfaqëson njërën nga veprat orkestrale të periudhës së hershme të kompozitorit për orkestër simfonike, e cila, po ashtu, ka pasur rastin edhe të ekzekutohet me sukses.

3. Zeqirja Ballata: "Vepra korale". - Është dorëzuar me kohë (tetor) dhe së shpejti do të botohet.

Vepra në fjalë përfshin gjithsej 42 këngë korale të ndara brenda gjinive të ngushta të të kënduarit koral: I. Këngë për kor të përzier (10); II. Këngë për kor meshkujsh (6); III. Këngë për kor femrash (5); IV. Këngë për kor pionierësh (21) të kompozuar gjatë periudhës kohore 1963-2011. Shumica absolute syresh janë të kompozuar mbi tekste poetësh të ndryshëm. Disa syresh janë të përpunuara, që d.m.th. burojnë nga këngët popullore. Këngët korale janë karakteresh nga më të ndryshmet: lirike, humoreske, të karakterit atdhetar, përkatësisht revolucionar, por edhe edukativ e paqësor. Ndonjëra syresh përfshin më vete qoftë ndonjë solist vokal a recitues, qoftë e shoqëruar me ndonjë instrument.

4. Monografia për piktorin Gjelo Gjokaj (anëtar i jashtëm) ka kohë që i është besuar ta shkruaj Shkëlzen Maliqi. Përkundër premtimeve se do ta kryejë z. Maliqi, nga njëra anë, dhe përpjekjeve tona të pandërprera nga ana tjetër, dorëshkrimi ende nuk është dorëzuar! Meqë ka kaluar kohë tepër e gjatë pa u dorëzuar punimi në fjalë, Seksioni vendosi t'i propozojë kolegut Gjelo Gjokaj ta zgjedhë një tjetër autor, ose Seksioni është i

gatshëm të propozojë dhe zgjedh vetë një autor tjetër.

5. Engjëll Berisha: “Përmbledhje romancash të kompozitorëve kosovarë”. - Është në përgatitje e sipër dhe duhet të dalë këtë vit. Këtë vit akademik Engjëll Berisha e ka dhe jubileun e tij - 80-vjetorin e lindjes, të cilin do ta marrë për sipër ta organizojë Seksioni i Arteve.

#### *Promovime*

1. Monografia për akademik Tahir Emrën, e shkruar me përkushtim nga piktori dhe historiani i artit prof. Kujtim Buza është përfunduar me sukses më 23 tetor 2013 në mjediset e Akademisë. Fjalën hyrëse e ka mbajtur akademik Zeqirja Ballata, fjalën kryesore autori i Monografisë prof. Kujtim Buza, ndërsa atë falënderuese akademik Tahir Emra.

#### *Ligjërata*

Nuk ka pasur.

Sekretari i Seksionit

Akademik Zeqirja Ballata, d. v.

### **VII. SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK**

Gjatë vitit 2013 punonjësit e Shërbimit profesional, administrativ e teknik të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës janë angazhuar me përkushtim rreth kryerjes së punëve të përcaktuara.

Ata edhe gjatë këtij viti kanë vazhduar t'i kryejnë detyrat e tyre në realizimin e Programit të punës të Akademisë. Është plotësuar vendi i zbrazët i punës sekretar teknik i Kryesisë së Akademisë. Pas pensionimit të punonjësës F. Dauti, në këtë vend të punës është pranuar znj. Dafina Kavaja. Po ashtu janë pranuar edhe tre punonjës të rinj: z. Hilmi Zogjani, përgjegjës i Njesisë së Bibliotekës, znj. Lirijeta Bunjaku, zyrtar për shpenzime/financiar dhe z. Ali Caka, drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale.

Në Bibliotekën e Akademisë ka vazhduar pasurimi i fondit librar me botime të reja të anëtarëve të Akademisë sonë, me botime të tjera që sigurohen nga shkëmbimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe përmes blerjes. Falë kushteve të mira që ofrojnë mjediset e reja të Bibliotekës, është shtuar numri i studiuësve që vijnë dhe i shfrytëzojnë librat e Bibliotekës.

Akademia jonë ka marrë pjesë me botimet e veta në Panairin e librit në Prishtinë, në Frankfurt dhe në Tiranë.

Punonjësit e këtij Shërbimi gjatë këtij viti kanë kryer trajnime e aftësime nga fusha përkatëse e punës dhe me përkushtim janë angazhuar që t'i kryejnë me sukses punët administrative, profesionale, teknike dhe punët e tjera për nevojat e Akademisë.

## RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2013

Mjetet e ndara sipas Ligjit të Buxhetit, të aprovuara për vitin 2013 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, janë **1,064,017.00 €** si total në të gjitha kategoritë. Buxheti sipas kategorive ekonomike pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

| Paga dhe mëditje | Mallra dhe shërbime | Shërbime komunale | Investime kapitale | Subvencione dhe transfere | Gjithsej     |
|------------------|---------------------|-------------------|--------------------|---------------------------|--------------|
| 624,017.00       | 430,000.00          | 10,000.00         | 0.00               | 0.00                      | 1,064,017.00 |

Buxheti përfundimtar është i pasqyruar si në vijim:

| Paga dhe mëditje | Mallra dhe shërbime | Shërbime komunale | Investime kapitale | Subvencione dhe transfere | Gjithsej     |
|------------------|---------------------|-------------------|--------------------|---------------------------|--------------|
| 613,288.62       | 424,220.00          | 10,000.00         | 0.00               | 0.00                      | 1,047,508.62 |

Sqarim: Shih tabelat e mëposhtme me sqarime shtesë.

### BUXHETI I MIRATUAR PËR VITIN 2013 ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR

|                           | Buxheti i aprovuar 2013 (A) | Alokime janar – dhjetor (B) | Realizime janar – dhjetor (C) | % (C/A) | % (C/B) |
|---------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-------------------------------|---------|---------|
| Paga dhe mëditje          | 624,017.00                  | 613,288.62                  | 613,281.31                    | 98.28%  | 99.99%  |
| Mallra dhe shërbime       | 430,000.00                  | 424,220.00                  | 423,049.06                    | 98.38%  | 99.72%  |
| Shërbime komunale         | 10,000.00                   | 10,000.00                   | 4,369.35                      | 43.69%  | 43.69%  |
| Subvencione dhe transfere | 0.00                        | 0.00                        | 0.00                          | 0.00    | 0.00    |
| Investime kapitale        | 0.00                        | 0.00                        | 0.00                          | 0.00    | 0.00    |
| Gjithsej                  | 1,064,017.00                | 1,047,508.62                | 1,040,699.72                  | 97.81%  | 99.35%  |



**Alokimet e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas rrjedhjes së parasë për periudhën janar – dhjetor**

Në buxhetin e përgjithshëm pjesëmarrja e alokimit në periudhën janar - dhjetor ka qenë **1,047,508.62€**, e shprehur në përqindje 98.45%.

|                           | Janar - Tetor | Nëntor    | Dhjetor   | Gjithsej €   | (%)    |
|---------------------------|---------------|-----------|-----------|--------------|--------|
| Paga dhe mëditje          | 520,014.18    | 52,001.41 | 41,273.03 | 613,288.62   | 98.28% |
| Mallra dhe shërbime       | 418,000.00    | 6,220.00  | 0.00      | 424,220.00   | 98.66% |
| Shërbime komunale         | 9,000.00      | 500.00    | 500.00    | 10,000.00    | 100%   |
| Subvencione dhe transfere | 0.00          | 0.00      | 0.00      | 0.00         | 0.00   |
| Investime kapitale        | 0.00          | 0.00      | 0.00      | 0.00         | 0.00   |
| Gjithsej                  | 947,014.18    | 58,721.41 | 41,773.03 | 1,047,508.62 | 98.45% |

**Realizimi i buxhetit për periudhën janar - dhjetor**

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit vjetor ka qenë **1,040,699.72€**, e shprehur në përqindje 99.35%.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

|                           | Alokime<br>Janar – Dhjetor<br>(A) | Realizimi<br>Janar – Dhjetor<br>(B) | Mbetja e<br>mjeteve<br>(C) | %<br>(B/A) |
|---------------------------|-----------------------------------|-------------------------------------|----------------------------|------------|
| Paga dhe mëditje          | 613,288.62                        | 613,281.31                          | 7.31                       | 99.99%     |
| Mallra dhe shërbime       | 424,220.00                        | 423,049.06                          | 1,170.94                   | 99.72%     |
| Shërbime komunale         | 10,000.00                         | 4,369.35                            | 5,630.65                   | 43.69%     |
| Subvencione dhe transfere | 0.00                              | 0.00                                | 0.00                       | 0.00       |
| Investime kapitale        | 0.00                              | 0.00                                | 0.00                       | 0.00       |
| Gjithsej €                | 1,047,508.62                      | 1,040,699.72                        | 6,808.90                   | 99.35%     |

### ***Pagat dhe mëditjet***

Buxheti i alokuar për paga dhe mëditje për vitin 2013 është **613,288.62€**, i shprehur në përqindje 98.28% dhe numri i aprovuar për personelin e ASHAK-ut është 55 individë.

#### **Alokimi**

|                  | Janar - Tetor | Nëntor    | Dhjetor   | Gjithsej € | %      |
|------------------|---------------|-----------|-----------|------------|--------|
| Paga dhe mëditje | 520,014.18    | 52,001.41 | 41,273.03 | 613,288.62 | 98.28% |

#### **Realizimi**

| Muaji      | Numri i punëtorëve | Buxheti    | Alokimi (A) | Realizimi (B) | Mbetja (A-B) |
|------------|--------------------|------------|-------------|---------------|--------------|
| Janar      | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 0.000         | 52,001.00    |
| Shkurt     | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 50,393.23     | 1,608.19     |
| Mars       | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 50,178.06     | 1,823.36     |
| Prill      | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 50,301.38     | 1,700.04     |
| Maj        | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 100,541.74    | (48,540.32)  |
| Qershor    | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 0.000         | 52,001.42    |
| Korrik     | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 51,622.15     | 379,27       |
| Gusht      | 55                 | 52,001.42  | 52,001.42   | 102,879.76    | (50,878.34)  |
| Shtator    | 55                 | 52,001.41  | 52,001.41   | 0.000         | 52,001.41    |
| Tetor      | 55                 | 52,001.41  | 52,001.41   | 51,214.50     | 786,91       |
| Nëntor     | 55                 | 52,001.41  | 52,001.41   | 104,156.39    | (52,154.98)  |
| Dhjetor    | 55                 | 52,001.41  | 41,273.03   | 51,994.10     | (10,721.07)  |
| Gjithsej € | 55                 | 624,017.00 | 613,288.62  | 613,281.31    | 7.31         |

Sqarim: Në kategorinë e pagave nuk është alokuar shuma prej 10,728.38€.

### ***Mallrat dhe shërbimet***

Buxheti i alokuar për mallra dhe shërbime për vitin 2013 është 424,220.00€. Alokimi i mjeteve për mallra dhe shërbime për periudhën janar-dhjetor përbën 98.66% të buxhetit.

**Alokimi**

|                     | Janar - Tetor | Nëntor   | Dhjetor | Gjithsej € | %      |
|---------------------|---------------|----------|---------|------------|--------|
| Mallra dhe shërbime | 418,000.00    | 6,220.00 | 0,00    | 424,220.00 | 98.66% |

**Realizimi**

| Kodi<br>1300 | Muaji   | Buxheti    | Alokimi<br>(A) | Realizimi (B) | Mbetja<br>(A-B) |
|--------------|---------|------------|----------------|---------------|-----------------|
| 1            | Janar   | 43,000.00  | 43,000.00      | 8,366.07      | 34,633.93       |
| 2            | Shkurt  | 40,000.00  | 40,000.00      | 18,535.56     | 21,464.44       |
| 3            | Mars    | 47,000.00  | 47,000.00      | 34,708.49     | 12,291.51       |
| 4            | Prill   | 70,000.00  | 70,000.00      | 37,411.50     | 32,588.50       |
| 5            | Maj     | 43,000.00  | 43,000.00      | 52,874.01     | (9,874.01)      |
| 6            | Qershor | 35,000.00  | 35,000.00      | 31,637.79     | 3,362.21        |
| 7            | Korrik  | 40,000.00  | 40,000.00      | 73,240.81     | (33,240.81)     |
| 8            | Gusht   | 37,000.00  | 37,000.00      | 28,899.29     | 8,100.71        |
| 9            | Shtator | 33,000.00  | 33,000.00      | 40,435.69     | (7,435.69)      |
| 10           | Tetor   | 30,000.00  | 30,000.00      | 12,705.80     | 17,294.20       |
| 11           | Nëntor  | 8,000.00   | 6,220.00       | 27,965.01     | (21,745.01)     |
| 12           | Dhjetor | 4,000.00   | 00.0000        | 56,269.04     | (56,269.04)     |
| Gjithsej     |         | 430,000.00 | 424,220.00     | 423,049.06    | 1,170.94        |

Sqarim: Në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 09/134 dt. 17.06.2013 ka pasur shkurtim buxhetor në vlerë prej 5,780.00€ për kategorinë mallra dhe shërbime.

***Shpenzimet për shërbime komunale***

Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2013 është 10,000.00€. Alokimi i mjeteve për shpenzime komunale për periudhën janar-dhjetor përbën 100% të buxhetit.

**Alokimi**

|                   | Janar - Tetor | Nëntor | Dhjetor | Gjithsej € | %    |
|-------------------|---------------|--------|---------|------------|------|
| Shërbime komunale | 9.000,00      | 500,00 | 500,00  | 10.000,00  | 100% |

**Realizimi<sup>1</sup>**

| Kodi<br>1400 | Muaji   | Buxheti   | Alokimi<br>(A) | Realizimi (B) | Mbetja<br>(A-B) |
|--------------|---------|-----------|----------------|---------------|-----------------|
| 1            | Janar   | 1,100.00  | 1,100.00       | 0             | 1,100.00        |
| 2            | Shkurt  | 1,000.00  | 1,000.00       | 414.37        | 585.63          |
| 3            | Mars    | 1,000.00  | 1,000.00       | 395.26        | 604.74          |
| 4            | Prill   | 900.00    | 900.00         | 801.02        | 98.98           |
| 5            | Maj     | 1,000.00  | 1,000.00       | 388.07        | 611.93          |
| 6            | Qershor | 1,000.00  | 1,000.00       | 150.38        | 849.62          |
| 7            | Korrik  | 1,000.00  | 1,000.00       | 625.38        | 374.62          |
| 8            | Gusht   | 500.00    | 500.00         | 363.48        | 136.52          |
| 9            | Shtator | 1,000.00  | 1,000.00       | 321.65        | 678.35          |
| 10           | Tetor   | 500.00    | 500.00         | 0             | 500.00          |
| 11           | Nëntor  | 500.00    | 500.00         | 317.83        | 182.17          |
| 12           | Dhjetor | 500.00    | 500.00         | 591.91        | (91.91)         |
| Gjithsej     |         | 10,000.00 | 10,000.00      | 4,369.35      | 5,630.65        |

**Donacioni – Granti i donatorit****Alokimi**

|                            | Totali i<br>grantit | Alokimi  | Realizimi | Mjete të<br>lira | %      |
|----------------------------|---------------------|----------|-----------|------------------|--------|
| Salbating<br>International | 20,000.00           | 4,060.00 | 3,977.68  | 16,022.32        | 20.30% |

Sqarim: Granti në vlerë prej 20,000.00€ i pranuar prej Salbating International si projekt i veçantë, i bartur nga vitet paraprake, me aprovim të donatorit ka pësuar ndryshime nga destinacioni fillestar. Nga vlera fillestare e projektit është bërë një transfer në vlerë prej 4,060.00€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve me qëllim të pasurimit të Bibliotekës së ASHAK-ut me vepra shkencore. Nuk ka pasur kërkesa të reja për alokime të tjera nga ky grant.

Realizimi i buxhetit në shkallën 96.40% tregon se është një performancë e mirë, e cila është realizuar në pajtueshmëri me Planin e rrjedhjes së parasë.

<sup>1</sup> Shpenzimet e komunaleve nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e rrymës dhe ato të mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

## PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2014





## I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

### *Projektet*

1. Fjalori enciklopedik i Kosovës. – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Gjatë vitit 2013 pritet të përfundojë hartimi i fjalësve të zërave për të gjitha fushat, të bëhet miratimi i fjalësit përfundimtar të Fjalorit nga Redaksia Qendrore, si dhe të përpilohet lista e autorëve-hartues të zërave. Ndërkaq, gjatë vitit 2014 parashihet të hartohen tekstet e zërave. Meqë versioni i parë i fjalësit të zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës ka arritur afër shtatë mijë njësi, mund të llogaritet se versioni përfundimtar do t'i ketë rreth 5000-5500 zëra, që domethënë se për hartimin e zërave do të angazhohen rreth 500 autorë të fushave të ndryshme. Gjatë vitit në vijim do të bëhet përpjekje të përfundojnë të gjitha punët rreth teksteve të zërave, siç është hartimi i teksteve, redaktimi i teksteve nga redaktori i fushës, redaktimi nga redaktori profesional dhe kryeredaktori, si dhe miratimi i versionit përfundimtar të teksteve nga Redaksia Qendrore.

2. Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe. – Deri në maj të vitit 2013 kryesimin e Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe e kishte Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe funksionimi i këtij Këshilli ka shkuar me vështirësi të natyrave të

ndryshme. Megjithatë, falë insistimit të vazhdueshëm të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit nga ASHAK dhe të Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, është arritur që disa grupe punuese ta përfundojnë punën dhe të dalin me propozimet përkatëse. Nga gjysma e dytë e vitit 2013 dhe prapa, përfshirë edhe vitin 2014, kryesimin e Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe do ta ketë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Me këtë rrethanë krijohen kushte më të mira për një punë më intensive dhe për koordinim më të mirë të grupeve të punës rreth çështjeve që do t'i shqyrtojë Këshilli. Puna e Këshillit gjatë kësaj periudhe do të konsistojë kryesisht në shqyrtimin e gjetjeve dhe rezultateve të punës të komisioneve të veçanta, të cilat i ka formuar Këshilli dhe tashmë janë duke punuar.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Me këtë projekt synohet studimi i tërësisë së zhvillimeve gjuhësore në Kosovë gjatë shekullit XX. Deri më tani është aktivizuar një njësi pilot për skanimin dhe digjitalizimin e dokumenteve, janë siguruar 230 numra të revistës “Përparimi” të periudhës 1955-1991 dhe janë skanuar ato, si dhe është hartuar lista gjithëpërfshirëse e numrave të skanuar. Janë siguruar gjithashtu të gjithë numrat e revistës “Jeta e re” nga viti 1949-1968 dhe janë bërë gati për skanim. Gjatë vitit në vijim do të sigurohen numrat që mungojnë të këtyre dy revistave dhe do të

vazhdohet me klasifikimin dhe përzgjedhjen për skanim të teksteve të periudhës 1945-1968, duke bërë edhe digitalizimin e tyre. Paralelisht me punët konkrete që do të kryhen rreth realizimit të projektit, do të punohet edhe për ngritjen e kapaciteteve dhe aftësimin teknik dhe profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Pas botimit të suksesshëm të librit të parë të veprës së plotë të Norbert Joklit, puna do të vazhdojë edhe më tej në përgatitjen dhe botimin e veprave të tjera të albanologut të shquar austriak. Gjatë vitit 2014 parashihet të bëhet gati për botim vëllimi i dytë i studimeve të Joklit me titull *Linguistische-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen* (Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes), i botuar më 1923. Përkthimi në shqip është bërë nga Anton Krajni në vitet '50 të shekullit XX në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer shpesh ka mungesa pjesësh, prandaj është paraqitur nevoja të bëhet krahasimi i plotë me origjinalin. Vepra është specifike gjuhësore, me vështrim vetëm krahasues dhe me shumë shprehje etnologjike. Mendohet që në këtë botim, pranë tekstit shqip, të jepet edhe teksti gjermanisht i skanuar me pagjimin origjinal në mënyrë që specialistët të kenë mundësi t'i referohen burimit.

#### *Tubimet shkencore*

##### 1. Konferencë shkencore për

studimet albanologjike. – Konferenca parashihet të mbahet në Prishtinë në gjysmën e dytë të vitit 2014. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ka propozuar që kjo konferencë shkencore të përfshihet edhe në protokollin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për periudhën 2013-2015. Mbajtja e tubimeve të nivelit të konferencave shkencore, në të cilat trajtohen në vijimësi çështje me rëndësi të veçantë për studimet në fushën e albanologjisë, tashmë është bërë pjesë e angazhimit të Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të ASHAK-ut. Në kuadër të këtij orientimi, gjatë viteve të shkuara janë mbajtur disa tubime të tilla shkencore për filologjinë shqiptare, për diakroninë e shqipes dhe për historinë e letërsisë shqipe. Në kuadër të këtyre angazhimeve, kjo konferencë do të synojë të tubojë albanologë shqiptarë dhe të huaj, të cilët do të bënin një përmbledhje dhe rekapitulum të arritjeve të studimeve në këtë fushë, duke vënë theksin në avancimin e mëtejshëm të punës shkencore në lëmin e albanologjisë.

2. Tryeza shkencore “Për kritikën letrare”. - Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut e kishte përfshirë në programin e punës së vet që më herët mbajtjen e një tryeze shkencore me këtë temë, si pjesë e bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Mosmbajtja e kësaj tryeze në Tiranë, siç ishte paraparë,



lë hapësirë për mbajtjen e saj në Prishtinë gjatë vitit 2014, sepse Seksioni konsideron se diskutimet për kritikën letrare paraqesin interes për letërsinë dhe nxisin pjesëmarrjen e një numri më të madh të studiuesve të letërsisë nga Kosova, nga Shqipëria dhe nga Maqedonia. Tryeza parashihet të mbahet në gjysmën e parë të vitit 2014.

### *Botimet*

1. Vëllimi II i veprës së Norbert Joklit. – Avancimi në realizimin e projektit për botimin e plotë të veprës së Norbet Joklit, i udhëhequr nga akademik Rexhep Ismajli, do të sjellë si rezultat botimin e vëllimit të dytë të veprës së albanologut të shquar austriak. Vepra *Linguistische-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen* (Hulumtime linguistike-kulturohistorike në fushë të shqipes) do të botohet paralelisht gjermanisht dhe shqip dhe kap vëllimin prej rreth 800 faqesh. Kopja në letër e përkthimit të veprës, bërë nga Anton Krajni, është marrë nga Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës (Instituti i Gjuhësisë), ndërsa radhitja e tekstit, me plot shenja diakritike speciale dhe me shembuj greqisht, sllavisht e në alfabetë të tjera, përfshirë edhe verifikimin e përkthimit, ka kërkuar një punë të gjatë e të përkushtuar, e cila pritët të kurorëzohet me botimin e veprës në gjysmën e dytë të vitit 2014.

2. Besim Bokshi: “Varia” (studime gjuhësore). – Dorëshkrimi i kësaj vepre të Besim Bokshit është përfunduar. Vepra përfshin një vëllim prej rreth 20 tabakë autori, me shkrime të ndryshme të Besim Bokshit me tematikë gjuhësore, që pjesërisht lidhet me veprimtarinë shkencore të autorit. Duke marrë parasysh se procedurat rreth dorëshkrimit do të përfundojnë gjatë vitin 2013, libri mund të futet në shtyp që në fillim të vitit 2014.

3. Rexhep Ismajli: “Studime për shqipen në rrethimin e saj ballkanik” (titull pune). – Libri parashihet të arrijë vëllimin prej 30 tabakësh autori. Do të përfshijë përmbajtje tematike për shqipen në raport me gjuhët e lashta të Ballkanit: vështrime për elementet e krahasueshme, për mundësitë e ndërlidhjeve të protoshqipes me to, gjithnjë në raport me diskutimet për lidhjet e shqipes me ndonjërin prej gjuhëve lashtoballkanike. Një vend të veçantë në këtë libër do të zënë raportet e rishikuara të shqipes me rumanishten, krahasimet për ngjashmëritë, por edhe dallimet midis dy gjuhëve, duke diskutuar tezat e autorëve rumunë dhe shqiptarë. Në libër gjithashtu do të zënë vend diskutimet për çështjen e zhvillimit të shqipes dialektore në raport me gjuhët e Ballkanit, sidomos sllave e rumune, etj.

4. Konferenca shkencore për studimet albanologjike. – Siç veprohet zakonisht në raste të

këtilla, kumtesat dhe kontributet e pjesëmarrësve të konferencës shkencore për studimet albanologjike do të përmbledhen në një botim të veçantë. Botimi i kësaj përmbledhjeje të kumtesave mund të shtyhet për vitin 2015, nëse konferenca mbahet në muajt e fundit të vitit 2014, siç është paraparë, sepse përgatitja e një përmbledhjeje të kësaj, me shumë autorë, merr më shumë kohë.

5. Revista “Studime” nr. 20. – Do të vazhdohet me botimin e numrit vijues të revistës “Studime”, të cilën e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut. Sikundër edhe deri më tash, revista do të botojë kontribute shkencore të autorëve të ndryshëm nga fusha e studimeve gjuhësore dhe letrare.

Sekretari i Seksionit

Akademik Mehmet Kraja, d.v.

## II. Seksioni i Shkencave Shoqërore

### *Projekte*

1. Fjalori enciklopedik i Kosovës. – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK. Gjatë vitit 2013 pritet të përfundojë hartimi i fjalësve të zërave për të gjitha fushat, të bëhet miratimi i fjalësit përfundimtar të Fjalorit nga Redaksia Qendrore, si dhe të përpilohet lista e autorëve-hartues të zërave. Ndërkaq, gjatë vitit 2014 parashihet të hartohen tekstet e zërave. Meqë versioni i parë i

fjalësit të zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës ka arritur afër shtatë mijë njësi, mund të llogaritet se versioni përfundimtar do t'i ketë rreth 5000-5500 zëra, që domethënë se për hartimin e zërave do të angazhohen rreth 500 autorë të fushave të ndryshme. Gjatë vitit në vijim do të bëhet përpjekje të përfundojnë të gjitha punët rreth teksteve të zërave, siç është hartimi i teksteve, redaktimi i teksteve nga redaktori i fushës, redaktimi nga redaktori profesional dhe kryeredaktori, si dhe miratimi i versionit përfundimtar të teksteve nga Redaksia Qendrore.

### *Konferenca dhe tryeza shkencore*

1. Konferencë shkencore “Lufta e Parë Botërore dhe çështja shqiptare”. - Konferenca do të organizohet nga ASHAK-u, në bashkëpunim me Institutin e Historisë të Prishtinës dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Konferenca është përfshirë edhe në Protokollin e bashkëpunimit ASHSH-ASHAK 2013-2015. Është me interes të trajtohet me argumente të nevojshme shkencore çështja shqiptare në një luftë të karakterit botëror, siç ishte Lufta e Parë Botërore, aq më tepër kur dihet se Shteti i Pavarur Shqiptar nuk kishte jetë më të gjatë se një vit e gjysmë.

Pritet që kjo konferencë shkencore, me një pjesëmarrje të gjerë të specialistëve të fushës dhe të studiuesve nga të gjitha hapësirat shqiptare, të kontribuojë

në shqyrtimin e gjithanshëm historik të kësaj periudhe të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar.

2. Tryezë shkencore “Arkeologjia në trojet shqiptare - sfidat dhe mundësitë”. - Zhvillimet bashkëkohore kanë hapur mundësi për bashkëpunim të qëndrueshëm në fushën e arkeologjisë midis shkencëtarëve dhe profesionistëve të cilët veprojnë në trojet shqiptare. Pasuria arkeologjike e trojeve shqiptare është shtresuar që nga periudha paleolitike dhe ajo shtron nevojën për thellimin e njohurive shkencore, mbrojtjen e integruar, prezantimin e denjë dhe shfrytëzimin ekonomik në të mirë të së sotmes dhe të nesërmes. Tema e propozuar mundëson analizën e gjendjes aktuale të trashëgimisë arkeologjike në aspektin shkencor, profesional dhe legjislativ. Duke u paraparë si temë nismëtare, kjo nënkupton dhe hapje të dyerve për bashkëveprim të koordinuar midis institucioneve dhe individëve të fushës, gjithnjë duke pasur parasysh prioritetet shkencore dhe profesionale.

3. Tryeza shkencore “Perspektivat e komplementaritetit në zhvillimin ekonomik ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe regjionit”. – Kjo tryezë ishte paraparë të mbahej në vitin 2013, por nuk u realizua për shkakë objektive dhe në Seksion u propozua që ajo të bartet në programin e punës për vitin 2014. Problemet e zhvillimit të strukturës

ekonomike të Kosovës çojnë në domosdoshmërinë e lidhjeve më të forta ekonomike me vendet fqinje. Këto lidhje për vendin tonë kanë rëndësi jo vetëm ekonomike, por edhe politike, sepse nëpërmjet tyre do të arriheshin objektivat më të gjera sociopolitike. Një tryezë në këtë temë do të mbledhte 8 – 10 studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Presheva e Bujanovci dhe nga Mali i Zi, për të prezantuar pikëpamjet e tyre lidhur me kushtet dhe me mundësitë e integritimeve dhe rritjes së komplementaritetit të ekonomive të këtyre vendeve dhe rajoneve.

#### *Botime*

1. Pajazit Nushi: “Leksikon i psikologjisë”. – Libër në dy vëllime, që përfshin rreth 73 tabakë autori. Leksikoni ka 5237 zëra të psikologjisë bashkëkohore. Zërat janë nxjerr nga literatura e psikologjisë më të re të sistemit të disiplinave të psikologjisë, ku psikologjia kognitiviste dhe psikologjia fiziologjike ka pësuar ndryshime të mëdha. Përmbajtja e këtij teksti përfshin zëra të rinj nga zhvillimi i psikologjisë, ndërsa zërave të përgjithshëm u janë shtuar zërat që bëjnë fjalë për specifikat shqiptare. Për nga shtrirja përmbajtjesore, zërat janë të ndarë të tri grupe: zëra të gjatë, zëra të mesëm dhe zëra të shkurtër. Për secilin nga zërat e gjatë dhe të mesëm është dhënë literatura burimore e përkthyer edhe në

gjuhën shqipe. Zërat nga psikologjia e motivacionit, e iluzioneve, e motorikës dhe e bazës biologjike të sjelljeve të njeriut kanë ilustrimet grafike. Ilustrime grafike kanë edhe zërat e psikometrisë. Autorët e zërave janë dhënë në gjuhën burimore me vit të lindjes dhe të vdekjes të tyre dhe njëkohësisht emri dhe mbiemri i secilit është transponuar në gjuhën shqipe. Në fund të përmbajtjes së leksikonit është dhënë një regjistër fobiesh kryesore prej 271 sosh. Do të përgatitet edhe indeksi i termave, përkatësisht indeksi i zërave dhe indeksi i antroponimeve.

2. Edi Shukriu: “Hyjnesha Dardane”. – Përmes trajtimit multidisiplinar shkencor kjo vepër sjell në pah njërën nga hyjnitë më të respektuar të panteonit dardan, jo shumë të njohur deri më sot. Libri përfshin studimin e kultit dhe të religjionit dardan, si çështje me shumë interes në kuadër të studimeve ilire dhe të antikiteti të rajonit. Në të përcillen fazat e zhvillimit të besimit dhe niveli i krijuar i sistemit religjioz dardan, në të cilin Hyjnesha Dardane fitoi edhe pozitë superiore në fazat e mëvonshme të besimi dardan. Libri përmban rreth 140 faqe dhe përfshin parathënien, paraqitjen e të gjitha monumenteve përkushtuar Hyjneshës Dardane, analizën e tyre, si dhe zhvillimin e besimit dardan në parahistori dhe antikë. Teksti përcillet me fotografi cilësore, skica, harta, literaturë dhe indeks të emrave.

3. Anton K. Berishaj: “Shoqëria segmentare - qasja socioantropologjike” (titull pune). – Në këtë hulumtim shkencor është aplikuar qasje multidisiplinare për shkak të kompleksitetit të formave dhe mënyrave të organizimit shoqëror, sistemit specifik të vlerave, lidhjen organike me traditën dhe normat zakonore, mitin e familjes, vatrës, shtëpisë (oxhakut), besimin dhe besëtytnitë, komunikimin me grupet e tjera, destruktivitetin dhe simbiozën që krijon komunikimi etj. Pjesë të popullatës shqiptare pas vendosjes së sistemit të timarit territorialisht dhe nominalisht i përkisnin Mbretërisë Osmane, mirëpo realisht e organizuan jetën jashtë kontekstit ligjor të saj, me forma të së drejtës zakonore, që përkon me modelin segmentar të jetës. Organizimi familjar, barkthi, barku, vëllazëria, fisi dhe lidhja fisnore pushojnë mbi bazën e normave të drejtës zakonore, Kanunit të Lekë Dukagjinit. Sistemi i vlerave, mekanizmat shoqërorë që e kompensojnë funksionimin e shtetit të organizuar politik dhe ndjenja e përkatësisë së një trugu të përbashkët shndërrohen në mekanizma homogjenizues. Ekonomizimi dhe siguri i mbijetesës në ambientin malor shndërrohet detyrueshëm në segmentarizëm shoqëror.

4. Arsim Bajrami: “Historia e konstitucionalizmit shqiptar”. – Studimi “Historia e konstitucionalizmit shqiptar nga viti

1912 e deri më sot” paraqet një hulumtim shkencor nga e drejta kushtetuese, i cili ka për qëllim të studiojë konstitucionalizmin shqiptar nga lindja e tij në vitin 1912 e deri më sot, duke specifikuar fazat dhe tiparet e zhvillimit të tij. Konstitucionalizmi shqiptar në esencë tregon emancipimin shtetëror të kombit shqiptar dhe ndërtimin e traditës shtetërore. Studimi pretendon që konstitucionalizmin shqiptar ta vështrojë në kuptimin kombëtar dhe shtetëror, duke hulumtuar në një anë konstitucionalizmin si proces shtetëror dhe në anën tjetër traditën kushtetuese të Shqipërisë, Kosovës dhe përvojat kushtetuese në Maqedoni. Studimi është i përbërë nga katër pjesë, të cilat përbëjnë një tërësi unike. Pjesa e parë i kushtohet zhvillimit të konstitucionalizmit në Republikën e Shqipërisë, pjesa e dytë atij në Kosovë dhe pjesa e tretë do të përfshijë Maqedoninë, ku jetojnë shqiptarët. Në pjesën e katërt jepen tendencat bashkëkohore në zhvillimin e konstitucionalizmit në kushtet e integriteteve evropiane dhe atyre kombëtare. Studimi synon të jetë gjithëpërfshirës, ka një vëllim me rreth 50 tabakë autori dhe mendohet të përfundojë në fillim të vitit 2014, kur edhe pritet botimi dhe promovimi i tij.

5. Muhamedin Kullashi: “Enigma e praktikave të dhurimit”. - Në këtë studim shqyrtohen hulumtimet antropologjike e filozofike bashkëkohore që problematizojnë

temën e dhuratës dhe të dhuruarit, si praktikë brenda qytetërimeve të ndryshme. Nga hulumtimet e shumta bashkëkohore për praktikën e të dhuruarit janë veçuar qasjet që bëjnë çështje dhuratat reciproke, të cilat ndriçojnë gjininë njerëzore gjatë historisë, si e përbërë nga individë shumë të veçantë, të cilët megjithatë detyrohen të jetojnë bashkë dhe të ndërtojnë shoqëri me trajta të ndryshme. Problematizimi filozofik i aktit të të dhuruarit shpie te nxjerrja e dallimeve midis praktikave ekonomike të këmbimit, atyre morale të ndihmës humanitare dhe veçantisë së “dhuratës reciproke ceremoniale” si procedurë e pranimit reciprok midis njerëzve (si gjest i sfidimit, i dhurimit dhe i bashkimit) që prodhon lidhjen sociale. Ndriçimi i enigmës së aktit të të dhuruarit është kërkuar përmes qëmtimit të praktikave dhe përfytyrimeve mbi të dhuruarit e të mirave, personave (martesa), gjesteve, fjalëve, valleve, festave që bëjnë të mundur aktin e pranimit (reconnaissance) reciprok midis njerëzve, aktin e dhurimit me të cilin njeriu “i jepet tjetrit përmes asaj që i jap”, me qëllim që të sajohet një lidhje.

6. Ekrem Murtezai: “Hyrje konceptuale në filozofi”. – Bëhet fjalë për një vepër të re të autorit nga fusha e studimeve filozofike.

7. Revista “Studime shoqërore” nr. 1. – Deri më tani revista “Studime” ka qenë botim i përbashkët i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të ASHAK-

ut. Në vitin 2014 Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK-ut do të fillojë të botojë revistën “Studime shoqërore”, në të cilën do të botohen studime, trajtesa, recensione dhe kritika nga disiplinat e shkencave shoqërore. Deri më tani janë kryer disa punë organizative, siç është ngritja e redaksisë së revistës dhe janë bërë punë fillestare për grumbullimin e shkrimeve për botimin e numrit të parë të revistës.

Sekretari i Seksionit

Akademik Mark Krasniqi, d.v.

### III. Seksioni i Shkencave të Natyrës

#### *Projekte*

1. Fjalori enciklopedik i Kosovës. – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Gjatë vitit 2013 pritet të përfundojë hartimi i fjalësve të zërave për të gjitha fushat, të bëhet miratimi i fjalësit përfundimtar të Fjalorit nga Redaksia Qendrore, si dhe të përpilohet lista e autorëve - hartues të zërave. Ndërkaq, gjatë vitit 2014 parashihet të hartohen tekstet e zërave. Meqë versioni i parë i fjalësit të zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës ka arritur afër shtatë mijë njësi mund të llogaritet se versioni përfundimtar do t'i ketë rreth 5000-5500 zëra, që domethënë se për hartimin e zërave do të angazhohen rreth 500 autorë të fushave të ndryshme.

Gjatë vitit në vijim do të bëhet përpjekje të përfundojnë të gjitha punët rreth teksteve të zërave, siç është hartimi i teksteve, redaktimi i teksteve nga redaktori i fushës, redaktimi nga redaktori profesional dhe kryeredaktori, si dhe miratimi i versionit përfundimtar të teksteve nga Redaksia Qendrore.

2. Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë. – Është ky projekt i përbashkët i Akademisë së Shkencave të Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i cili ka filluar të realizohet që nga viti 2012. Bëhet fjalë për një projekt afatgjatë, prandaj, si i tillë, është përfshirë edhe në Protokollin e bashkëpunimit ndërmjet ASHAK dhe ASHSH për periduhën 2013-2015. Për vitin e parë të hulumtimeve, koordinatori i projektit ka bërë raportin me shkrim nga i cili mund të shihet se janë kryer pothuajse përfundimisht punët e planifikuara sa i përket pjesës që ka të bëjë me Kosovën. Në vitin në vijim, Seksioni i Shkencave të Natyrës do të intensifikojë bashkëpunimin me seksionin përkatës të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në mënyrë që të mos ketë ngecje në realizimin e tërësishëm të projektit.

3. Bimët e rrezikuara e të rralla të florës së Kosovës. - Projekti është nga fusha e ruajtjes së mjedisit dhe ka karakter hulumtues shkencor. Ndikimi i faktorit njeri në florën dhe vegetacionin, përkatësisht në biodiversitetin e përgjithshëm

autokton është shumë i madh. Puna në projekt ka për qëllim që të studiojë në mënyrë të hollësishme dhe të gjithanshme taksonet e rrezikuara e të rralla që mund të zhduken, si dhe endemitet, reliktet e endemoreliktet e ndryshëm të florës së Kosovës. Do të bëhet evidencimi i tyre në trevën e Kosovës dhe do të caktohet shkalla e rrezikshmërisë sipas kriterëve e standardeve ndërkombëtare. Realizimin e projektit do ta bëjnë 7 hulumtues nga Departamenti i Biologjisë i FSHMN dhe dy nga ASHAK-u. Projekti ka për qëllim që të studiojë në mënyrë të hollësishme dhe të gjithanshme taksonet e rrezikuara e të rralla që mund të zhduken. Me këtë rast do të përfshihet biologjia përkatëse e çdo taksoni, forma jetësore, organet vegjetative e gjenerative, areali i përhapjes së përgjithshme dhe atij brenda territorit të Kosovës, vitaliteti, popullacioni në vendarritjen e tyre, elementi floristik, vlera shkencore, ekonomike e kombëtare e tyre, shkalla e rrezikueshmërisë, caktimi i faktorëve që ndikojnë në rrezikimin e madje edhe në zhdukjen e tyre, masat mbrojtëse që duhen ndërmarrë, etj.

4. Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre. - Ky projekt i takon kimisë së mjedisit dhe ka karakter hulumtues dhe aplikativ. Projekti ka për qëllim identifikimin e ndotësve të ujërave sipas standardeve shkencore, që përdoren në tërë botën. Njëherësh do të analizohen sistemet e ndryshme të pastrimit të ujërave të ndotura. Ndotja e ujit në Republikën e

Kosovës shkaktohet nga disa burime: Ujërat industriale, efluentët e ujërave urbane, ndotësit nga fabrikat (Feronikeli, Fabrika e Çimentos, fabrikat ushqimore), termocentralet, flotacioni i Trepçës, deponitë e Trepçës dhe Kishnicës etj. Në varësi nga parametrat e hulumtuar, do të aplikohen metodat e veçanta, si: metodat biologjike, metodat fiziko-kimike dhe proceset membranore (ultrafiltrimi dhe osmoza e kundërt). Nga realizimi i këtij projekti do të krijohen laboratorë të pajisur mirë për studime afatgjata. Në realizimin e projektit do të marrin pjesë Seksioni i Shkencave të Natyrës i ASHAK-ut dhe Departamenti i Kimisë i Universitetit të Prishtinës. Puna në këtë projekt tashmë ka filluar dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2014.

5. Ndikimi i mbitensioneve atmosferike në sistemet elektroenergjetike të Kosovës. – Në projekt do të trajtohet analiza e shkarkimeve atmosferike për disa linja transmetuese të sistemit elektroenergjetik të Kosovës në varësi nga densiteti dhe amplitudat e shkarkimeve atmosferike. Kjo do të mundësojë që të propozohen rekomandimet për koordinim të izolimit si kompromis ndërmjet mbitensioneve, pajisjeve mbrojtëse dhe shkallës së izolimit. Qëllimi i hulumtimit është kontributi në modelimin, analizën empirike, realizimin dhe përpunimin e matjeve, regjistrimeve dhe mbikëqyrjen e shfaqjes së mbitensioneve atmosferike dhe ndikimin e tyre në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, me theks të veçantë në linjat transmetuese të



tensionit të lartë. Projekti ka filluar të realizohet në vitin 2012, por në Seksionin e Shkencave të Natyrës është konstatuar se për përfundim të suksesshëm të projektit është e nevojshme zgjatja e afatit edhe për një vit me qëllim të grumbullimit sa më shumë të së dhënave për frekuencën e zbrazjeve të rrufeve në territorin e Kosovës. Për këtë qëllim është propozuar që projekti të vazhdojë edhe për vitin 2014.

6. Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe në Shqipëri. – Është projekt i përbashkët, i cili në pjesën më të madhe të tij tashmë është realizuar si formë e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Puna do të vazhdojë edhe në të ardhmen, deri në përfundimin e tij. Me qëllim të realizimit të tërësishëm dhe sa më të plotë, projekti është përfshirë edhe në në Protokollin e bashkëpunimit ndërmjet ASHAK-ut dhe ASHSH-së për periudhën 2013-2015.

#### *Konferenca dhe tryeza shkencore*

1. “Ujitja në Kosovë”. - Në këtë tryezë shkencore të organizuar nga Seksioni i Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut synohet të identifikohen faktorët apo karakteristikat kryesore që ndikojnë në kushtet e ujitjes për vendin në tërësi, sipas pellgjeve lumore si njësi themelore e ekonomisë së ujërave dhe autoriteteve të pellgjeve si njësi për administrimin e ujërave. Është

vlerësuar se diskutimi i kësaj teme në një tryezë shkencore është me rëndësi për shfrytëzimin racional dhe të efektshëm të tokës, rritjes së rendimenteve, stabilizimit të prodhimtarisë bujqësore, rritjes së punësimit, standardit e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Pasuritë ujore në Kosovë nga aspekti i kriterëve natyrore konsiderohen si relativisht të mira, por ato cilësohen me presion të madh nga aspekti i kërkesave për shfrytëzim dhe ndikimeve ekologjike. Në bazë të analizës së kushteve pedogjene dhe topografisë së terrenit vlerësohet se në Kosovë ekzistojnë mundësitë për ujitjen e mbi 200.000 ha ose rreth 50% e sipërfaqeve bujqësore. Janë të rralla vendet që disponojnë kushtet të tilla natyrore pedogjene, topografike dhe hidrike për zbatimin e ujitjes.

#### *Botime*

1. Nexhat Daci: “Mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm”. - Për shkak të kompleksitetit të çështjes së mjedisit dhe nevojës për shqyrtim të gjithanshëm dhe të qëndrueshëm shkencor, botimi i kësaj vepre, i paraparë për vitin 2013, do të bartet në vitin vijues. Deri më tani autori ka arritur të kryejë një pjesë të mirë të punës rreth hartimit të kësaj vepre, duke identifikuar çështjet bazë të shqyrtimit shkencor. Por, duke marrë parasysh se shkencës në Kosovë i mungon një botim që trajton mjedisin në kompleksitetin e tij, e për shkencëtarët e rinj do të



jetë një ndihmesë e konsiderueshme në rrugëtimin e tyre, kërkohet angazhim shtesë i autorit dhe kohëzgjatje më e madhe për ta realizuar veprën në tërësinë e saj. Prandaj botimi i kësaj vepre mund të realizohet gjatë vitit 2014.

2. Fejzullah Krasniqi: "Termocentralet e Kosovës". - Qëllimi i kësaj vepre është që t'i ofrohet opinionit kosovar dhe opinionit më të gjerë një studim për termocentralet në përgjithësi dhe për termocentralet e Kosovës në veçanti, me analizat energjetike dhe eksergjietike përkatëse, me ndikim për rritjen e rendimentit të termocentraleve. Deri më tani një boti i këtillë monografik, ku do të përpunohej tërë problematika e ndërtimit dhe e shfrytëzimit të termocentraleve në Kosovë, ka munguar te ne. Meqë në Kosovë tashmë është krijuar një përvojë e caktuar profesionale e punës, e shfrytëzimit dhe e prodhimit të energjisë elektrike nga termocentralet, me tendenca praktike për rritjen e rendimentit të tyre të përgjithshëm, një vepër e tillë padyshim se do të ishte një ndihmesë për opinionin shkencor e profesional në Kosovë dhe më gjerë. Meqë vepra është shumë komplekse dhe meqë autori synon rezultate shkencore të qëndrueshme, botimi i saj i paraparë për vitin 2013 do të bartet në vitin 2014.

3. Qamil Haxhibeqiri: "Hapësirat metrike". - Shumë kuptime të rëndësishme në matematikë, siç janë kuptimi i vazhdueshmërisë së funksionit, konvergjencës së vargjeve,

limitit, derivatit, integralit të një funksioni real etj., varen kryesisht nga largesa e pikave (numrave) reale që përkufizohet si vlerë absolute e ndryshimit të tyre. Nëse në ndonjë bashkësi të çfarëdoshme mund të përkufizohet kuptimi i largesës së cilado dy pikave të asaj bashkësie, e që i ka vetitë e ngjashme me ato të vlerës absolute të numrave (pikave) realë, atëherë kuptimet e mësipërme mund të përgjithësohen edhe për vargjet dhe funksionet e bashkësive të tilla. Krahas përkufizimit të hapësirës metrike dhe ilustrimit me shembuj karakteristikë të këtij kuptimi, do të studiohen veprimet me hapësira metrike si dhe disa kuptime metrike të hapësirave të tilla. Struktura topologjike e hapësirave metrike dhe përgjithësimi i tyre - hapësirat topologjike do të jenë, po ashtu, objekt studimi. Konvergjenca e vargjeve të hapësirave metrike, hapësirat e plota metrike, karakterizimet e ndryshme të hapësirave të tilla, teorema e Banahut mbi pikën fikse si dhe disa zbatime të saj do të jenë objekt shqyrtimi. Kompaktësia dhe lidhshmëria e hapësirave metrike dhe e atyre topologjike do të zënë vend qendror në këtë libër. Libri do të ketë një vëllim afro 250-300 faqe.

4. Ruzhdi Pllana: "Klima e Kosovës". - Bëhet fjalë për një studim monografik, i pari i këtij lloji, në të cilin analizohen në mënyrë komplekse roli i faktorëve globalë, rajonalë dhe lokalë në kushtet klimatike të Kosovës, si dhe analiza e elementëve klimatikë në vend.

Studimi është rezultat i punës shumëvjeçare në mbledhjen, sistemimin dhe përpunimin e të dhënave statistike për elementet klimatik etj. Në prezantimin, analizën dhe interpretimin e rezultateve të hulumtimit janë zbatuar metoda të ndryshme statistike, të analizës, të sintezës, metoda krahasuese, metoda grafike, hartografike etj. Në monografi prezantohet analiza e elementeve klimatike për periudhën standarde sipas kriterëve dhe metodologjisë së Organizatës Botërore të Meteorologjisë (WMO) dhe të përvojave në rajon. Në bazë të analizës së ndikimit të faktorëve fiziko-geografikë dhe analizës së elementeve klimatike, do të përcaktohen karakteristikat klimatike dhe rajonimi klimatik i Kosovës. Botimi i monografisë Klima e Kosovës, përveç tekstit do të përbëjë disa dhjetëra tabela, klimadiagrame dhe harta tematike. Monografia do të ketë rreth 250-300 faqe.

5. Revista “Kërkime” nr. 20. – Gjatë vitit 2014 do të përgatitet për shtyp numri 20 revistës “Kërkime”, e cila boton tekste dhe kontribute shkencore nga fusha e shkencave të natyrës dhe të shkencave të tjera fundamentale. Sikundër edhe deri më tash, edhe në këtë numër të revistës do të botohen punime shkencore të anëtarëve të Seksionit të Shkencave të Natyrës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm,

tekste të tilla që do t’i plotësojnë kriteret shkencore, pas vlerësimit profesional që do t’u bëhet nga redaksia e revistës.

Sekretari i Seksionit

Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

#### IV. Seksioni i Arteve

##### *Projekte*

1. Fjalori enciklopedik i Kosovës. – Është projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të ASHAK-ut. Gjatë vitit 2013 pritët të përfundojë hartimi i fjalësve të zërave për të gjitha fushat, të bëhet miratimi i fjalësit përfundimtar të Fjalorit nga Redaksia Qendrore, si dhe të përpilohet lista e autorëve-hartues të zërave. Ndërkaq, gjatë vitit 2014 parashihet të hartohen tekstet e zërave. Meqë versioni i parë i fjalësit të zërave të Fjalorit enciklopedik të Kosovës ka arritur afër shtatë mijë njësi, mund të llogaritet se versioni përfundimtar do t’i ketë rreth 5000-5500 zëra, që domethënë se për hartimin e zërave do të angazhohen rreth 500 autorë të fushave të ndryshme. Gjatë vitit në vijim do të bëhen përpjekje të përfundojnë të gjitha punët rreth teksteve të zërave, siç është hartimi i teksteve, redaktimi i teksteve nga redaktori i fushës, redaktimi nga redaktori profesional dhe kryeredaktori, si dhe miratimi i versionit përfundimtar të teksteve nga Redaksia Qendrore.

### *Koncerte*

1. Mbrëmje artistike me vepra muzikore, pamore dhe poetike të anëtarëve të Akademisë. – Është paraparë si një formë e përshtatshme e prezantimit të përbashkët të krijuesve të fushës së poezisë, artit muzikor dhe artit pamor, një mbrëmje artistike në të cilën do të performojnë krijuesit e këtyre fushave të artit, që njëkohësisht janë anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Mbrëmja do të përfshijë ekzekutimin e veprave muzikore, recitimin e vargjeve poetike, si dhe ekspozimin e veprave figurative në një hapësirë të përshtatshme.

### *Ekspozita*

1. Ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi. – Seksioni i Arteve i Akademisë ka paraparë që gjatë vitit 2014 të mbahet ekspozita e anëtarit korrespondent Luan Mulliqit. Ekspozita do të përfshijë rreth 30 vepra skulpturore të realizuara në bronz. Koncepti i ekspozitës do të jetë prezantimi i disa cikleve të krijimtarisë së këtij autori, duke filluar nga cikli i monumenteve kushtuar personaliteteve të njohura, siç janë shtatorja e Skënderbeut, e Nënës Terezë, e Presidentit Rugova, e akademik Fehmi Aganit dhe deri te krijimtaria e tij që përfshin ciklin “Balerinat” (cikël i ndërtuar mbi perceptimin e autorit rreth rolit historik të femrës në shoqëri), si

dhe të ciklit të fundit “Portat”, i cili përfshin vepra skulpturale që simbolizojnë zhvillimin tonë shoqëror drejt hapësirave të reja.

2. Ekspozita personale e Tahir Emrës. – Ekspozita me veprat e akademik Tahir Emrës, me të cilën do të shënohet 50-vjetori i krijimtarisë së këtij autori, ishte paraparë të realizohej gjatë vitit 2013, por për shkak të rëndësisë së projektit dhe nevojës për një punë më të përqendruar krijuese dhe organizative, është vendosur që ajo të realizohet gjatë vitit 2014. Në hapësirat e Akademisë, me një aranzhim të kujdesshëm dhe me përgatitjen adekuate, ekspozita do të prezantojë retrospektivën e krijimtarisë pikturale të Tahir Emrës, duke përfshirë veprat më të rëndësishme dhe fazat kryesore të punës krijuese të piktorit.

### *Botime*

1. Zeqirja Ballata: “Gjurmëve të Muzës II”. – Akademik Zeqirja Ballata, përveç si kompozitor, për një kohë të gjatë është marrë edhe me çështje studimore, që kanë të bëjnë me artin muzikor, veçmas me krijimtarinë e autorëve të veçantë, veprat e të cilëve ai i analizon dhe i trajton nga aspekte të ndryshme. Përvoja e gjatë në punë të krijimtarisë muzikore, si dhe njohja e themeltë e punës krijuese nga kjo fushë, ka bërë që autori të merret me studime dhe trajtime muzikologjike, shqyrtime këto që ndriçojnë një varg veprash të gjinive të ndryshme të autorëve shqiptarë, përgjatë dy shekujve të fundit, vepra dhe autorë që nuk janë studiuar deri më tani. Duke

qenë një përmbledhje studimesh të kësaj natyre, libri paraqitet me interes për studiuesit e kësaj fushe, sikundër edhe për një masë më të gjerë lexuesish.

2. Rauf Dhomi: “Dasma arbëreshe”. – Duke ndjekur përvojat e deritashme të botimit të partiturave të veprave të ndryshme muzikore, Seksioni i Arteve i ASHAK për vitin 2014 ka paraparë botimin e partiturës së operës së Rauf Dhomit “Dasma arbëreshe”. Bëhet fjalë për një vepër të njohur të këtij autori, për operën e dytë të tij, e cila tashmë ka njohur realizimin skenik shumë vite më parë. Botimi i partiturës së operës “Dasma arbëreshe” do t’i shërbejë njohjes më të gjerë të kësaj veprë nga një auditor më i gjerë studiuesish dhe përdoruesish të tjerë

të veprave muzikore.

#### *Aktivitet*

1. Shënimi i 80-vjetorit të akademik Engjëll Berishës. – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës edhe gjatë vitit 2014 do të vazhdojë traditën e shënimit të 80-vjetorit të lindjes së anëtarëve të saj. Kësaj radhe do të shënohet 80-vjetori i lindjes së akademik Engjëll Berishës, aktivitet ky që do të konceptohet nga Seksioni i Arteve të ASHAK-ut dhe do të realizohet në bashkëpunim me strukturat administrative dhe me Kryesinë e ASHAK-ut.

Sekretari i Seksionit

Akademik Zeqirja Ballata, d.v.

*Shënim:* Të gjithë seksionet e Akademisë edhe gjatë periudhës së ardhshme do të vazhdojnë të organizojnë promovimin e veprave të botuara të anëtarëve të Akademisë, si dhe ligjërata dhe paraqitje të ndryshme me interes për një auditor më të gjerë, përfshirë edhe ligjëratat e ndërsjella të anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

**PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË  
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**





## PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXIX e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbajtur më 20 shkurt 2013 në orën 11:00 në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Engjëll Berisha, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Latif Susuri, Mark Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Pajazit Nushi, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Ruzhdi Pllana, Salih Gashi, Zejnullah Rrahmani.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar.

Kuvendi e miratoi këtë

### *Rend dite:*

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXVIII të Kuvendit;
2. Miratimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2012;
3. Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2012.

Pas miratimit të rendit të ditës kryetari Islami në mënyrë përmbledhëse paraqiti vlerësimet e tij

për veprimtarinë e Akademisë gjatë vitit 2012 si më poshtë:

”Kolege dhe kolegë të nderuar,

Po e mbajmë sot Kuvendin e parë të këtij viti, me një risi të madhe, sepse për herë të parë marrin pjesë anëtarët e rinj të Akademisë, 12 anëtarë korrespondentë nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve. Urime pjesëmarrja e parë në organin më të lartë të Akademisë, në Kuvend.

Vitin që shkoi Akademia mbajti gjithsej 16 mbledhje të Kryesisë dhe 3 kuvende. Përveç detyrave dhe programeve të punës të miratuara në seksione, në Kryesi dhe në Kuvend që në qershor të vitit 2011, vitin 2012 e përshkuan edhe disa angazhime dhe sfida shtesë.

Së pari, patëm një shpërthim produktiv, jetik për Akademinë: nga 1 janari 2012 ndodhi përmirësimi i gjendjes financiare të anëtarëve të Akademisë. Pas shumë përpjekjeve u arrit zbatimi i një vendimi të ligjshëm të një Qeverie të mëparshme dhe më në fund 25 anëtarë të ASHAK-ut u barazuan me profesorë të UP-së. Me këtë gjendje kemi hyrë edhe këtë vit, përfshirë edhe 12 anëtarët e rinj. Për mbijetesë dhe ruajtje të dinjitetit të anëtarit të Akademisë kemi siguruar mjete, por për shkencë dhe hulumtime shkencore nuk janë të mjaftueshme. Raporti i progresit vazhdon të bëjë vërejtje rreth ngecjeve në sferën e shkencës dhe të hulumtimit, vërejtje për MASHT-in dhe Qeverinë, duke marrë për bazë Ligjin për veprimtari kërkimore-shkencore, i

cili ende nuk është bërë, ndërkaq afati ka qenë që të votohet në Parlament deri më 30 mars 2012. Në vend të tij iu vërsulën Ligjit për Akademinë!

Së dyti, sfida më e madhe për vitin që shkoi ishin zgjedhjet e rregullta për pranimin e anëtarëve të rinj të Akademisë, për avancimin e anëtarëve korrespondentë dhe zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm. Mund të themi se e përmbyllëm me shumë sukses këtë proces mjaft të përgjegjshëm, të cilin e hapëm më 25 maj 2012 në mbështetje të çdo germe të Ligjit, të Statutit dhe të Rregullores për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, duke respektuar dhe kriteret profesionale-shkencore dhe artistike, që ishte si një parakusht themelor për jetën e kësaj themelte; u bë përtëritja, u mbuluan disa fusha të pambuluara, hynë njerëz me një bagazh shkencor, artistik, krijues, të pjekur edhe me moshë, u zgjodhën anëtarë të jashtëm me shumë autoritet në mjediset e tyre, të pranueshëm për Akademinë dhe opinionin.

Konkurrenca ishte shumë e madhe, më e madhja në historinë e Akademisë. Për herë të parë pati një vullnet për t'u marrë parasysh propozimet e seksioneve. Në Kuvendin zgjedhor erdhën për të votuar të gjithë anëtarët e Akademisë. Votimi ishte i lirë i mbështetur në normat në fuqi dhe ndërgjegjja mbeti në duar të votuesve.

Së treti, shpenzuam shumë kohë duke u përballur me një agresivitet tejet të madh të grupeve, klaneve dhe individëve që donin ta impononin me

dhunë Ligjin sipas vullnetit të tyre dhe ta prishnin madje edhe procesin zgjedhor, i paraparë të përfundonte më 5 dhjetor 2012. Kërkesa e tyre për Ligjin në Kuvend përfundoi pa debat, duke iu përcjell Qeverisë për hartimin apo amendamentimin e tij. Këtu na ndihmoi vetë Kryeministri. Kryesia e Akademisë ka kohë që e ka formuar grupin e vet për shqyrtimin e Ligjit dhe grupi po punon dhe versionin e vet do t'ia ofrojë instancave përkatëse. Sipas një njoftimi me shkrim të këtyre ditëve nga MASHT-i, Qeveria e ka angazhuar MASHT-in për themelimin e grupit për hartimin e Ligjit, ku do t'i kemi edhe ne përfaqësuesit tonë.

Së katërti, viti 2012 ishte një vit i madh për të gjithë shqiptarët – 100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë. Akademia institucionalisht ishte ndër më aktivet në shënimin e tij e këtij përvjetori; organizoi aktivitete të dendura e dinjitoze: 3 aktivitete i pati bashkë me Institutin e Historisë - 100-vjetorin e themelimit dhe të ekzistimit të Shoqatës Panshqiptare "Vatra", Akademinë – kujtesë historike, kushtuar 100-vjetorit të mbajtjes së Kuvendit të Junikut, Konferencën Shkencore dyditore në shtator dhe dy aktivitete artistike në nëntor dhe dhjetor: Ekspozitën e veprave pamore të autorëve shqiptarë dhe koncertin solemn; anëtarët e Akademisë morën pjesë në manifestimet finale në Tiranë e Vlorë edhe me kumtesa shkencore në tubimet përkatëse shkencore, që i organizoi Akademia e Shqipërisë dhe QSA-ja.

Së pesti, pas shumë përpjekjeve



arritëm ta dizajnonim dhe funksionalizim dhe faqen e internetit. Aty janë të gjitha të dhënat dhe informacionet e Akademisë, përfshirë edhe ato ditore, javore, periodike. Mbetet problem që faqja e internetit të mbahet edhe anglisht, por në një anglishte të rrjedhshme, pa gabime. Nuk është lehtë të gjendet njeriu; nuk e kemi njeriun as për shqip; falë punës së akademik Eqrem Bashës erdhëm deri këtu.

Sa i përket realizimit të programit të punës për vitin 2012 kryesisht jemi të kënaqur, ndonëse ka edhe disa ngecje për arsye të ndryshme, para së gjithash financiare, ndërsa ngecjet më të mëdha janë në temat të cilat janë të përbashkëta me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, e cila kryesisht nuk i realizoi pikat e veta të obligimeve, ndërsa arsyetime ose nuk jepen fare ose ato që jepen nuk janë bindëse. Por ka pika të përbashkëta të Protokollit 2011-2013, të cilat i ka iniciuar dhe propozuar Akademia jonë (Seksionet), e të cilat nuk janë realizuar. Mosaktiviteti del i dyanshëm.

Sa për informacion, ne nuk morëm pjesë në 40-vjetorin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, sepse u ftua SANU dhe njerëzit e grupit të Memorandumit. Kjo Akademi është afruar shumë me disa akademi të ish-Jugosllavisë, veçanërisht me atë malazeze, maqedone dhe serbe; në rastin tonë këto dy të parat sillen si të jenë punkte të SANU-së!

Ishte një vit kur e humbëm anëtarin tonë akad. Ali Podrimjen.

Akademia mori përsipër gjithë ceremoninë e varrimit dhe me këtë rast dëshmoi se është në gjendje, me këto kapacitete që ka, të drejtojë edhe aktivitete të tilla, të hidhura, por organizativisht të menduara dhe të drejuara në nivelin më të lartë të mundshëm: mbledhja komemorative, homazhet, varrimi nderuan figurën e shquar të letrave shqipe, me të gjitha meritat që i takojnë. Në ceremoni të varrimit morën pjesë funksionarë të lartë të Qeverisë sonë dhe të Shqipërisë. Morëm edhe shumë telegrame ngushëllimi.

Edhe me rastin e vdekjes së anëtarit tonë të jashtëm prof. Tomë Berishës organizuam mbledhjen komemorative (2. 3. 2012) dhe dërguam dy anëtarë në varrim në vendlindjen e tij në Mal të Zi, akad. Mark Krasniqin dhe anëtarin korrespondent Fezullah Krasniqin.

### 1. Botimet dhe projektet:

Pas daljes nga shtypi të monografisë "Kosova" dhe promovimit të saj në Prishtinë dhe në Tiranë, vitin e kaluar u bë përgatitja e botimit në gjuhën angleze. Dorëshkrimi është gati dhe pas disa procedurave teknike pritet të dorëzohet në shtyp dhe të del deri nga gjysma e këtij viti. Pasi dolëm në godinën e re dhe gjetëm një mbështetje buxhetore u krijuan kushtet për fillimin e punës në projektin afatgjatë "Enciklopedia e Kosovës". E do t'i prijë "Fjalori enciklopedik i Kosovës": vitin e kaluar u bë ndërtimi i strukturës organizative të

Fjalorit (u zgjodhën Bordi, Redaksia Qendrore, redaksitë e fushave, Këshilli i Enciklopedisë, kryeredaktori i Enciklopedisë, redaktorët dhe sekretari – në 4,5 fage e keni në materiale), si dhe u trajnuar stafi, u hartua fjalësi i zërave dhe u caktuan hartuesit e tyre. Dolën numrat përkatës të revistave "Kërkime" dhe "Studime"; botimi voluminoz i Konferencës "Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit", përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli; vepra "Kënaqësia e leximit" e akad. Ali Aliut; "Politika, lufta dhe diplomacia (Anarkia ndërkombëtare dhe e drejta)" e akad. Muhamedin Kullashit; "Aspekti etnik i migrimeve" i akad. Hivzi Islamit; botimi nga tryeza shkencore "Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Republikës së Kosovës"; botimi nga tryeza shkencore "Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore"; studimi "Qymiri i Republikës së Kosovës" i akad. Minir Dushit; "Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë" nga akad. Latif Susuri dhe dr. Arben Myrtaj; Fjalor shpjegues i termave të botanikës" si botim i përbashkët i ASHAK dhe ASHSH, në të cilin nga ana jonë punuan disa vjet akad. F. Krasniqi dhe akad. L. Susuri; doli botimi "Tri vepra vokalo-instrumentale (Këmbë qëndrese; Bir i vendit trimëror; Promemoria 1462)" të akad. Zeqirja Ballatës, ndërkaq në shtyp gjendet libri studimor "Të menduarit dhe të shkruarit juridik (me vështrime të përgjithshme nga fusha e metodologjisë së hulumtimit shkencor)" e akad. Esat Stavilecit, etj. Po punohet intensivisht në nxjerrjen në dritë të veprës së plotë të

akademikut të ndjerë Ali Podrimjes, obligim të cilin e morëm publikisht në mbledhjen komemorative.

Të gjitha dorëshkrimet që ishin gati u botuan. Janë disa projekte afatmesme dhe afatgjata në të cilat puna është në faza të ndryshme të realizimit të tyre; disa po ecin mirë, ndërkaq disa prej tyre, që kërkojnë punë hulumtuese në laborator dhe në terren, siç janë "Identifikimi i ndotësve të influentëve të ujërave urbane dhe të industrisë" dhe "Bimët e rrezikuara e të rralla të florës së Kosovës" po shtyhen në mungesë të mjeteve. Nuk kemi institute hulumtuese me laboratore, institute të shkencave shoqërore, atele për Seksionin e Arteve etj. Duhet parë punën e momorandumeve të bashkëpunimit me fakultetet përmes UP-së dhe këtu sekretarët e seksioneve duhet të prijnë, bashkë me sekretarin e përgjithshëm. E dimë që nuk shkojnë lehtë këto punë.

Investimet për shkencë dhe hulumtime mbeten tepër të vogla në gjithë Kosovën e pas luftës: me Ligjin mbi veprimtaritë kërkimore-shkencore të vitit 2004 të gjitha mjetet i grabitën OJQ-të. Vetëm 0,7% të GDP-së (hapësira evropiane synon 3%) parashihej të ndaheshin për shkencë dhe hulumtime, që në vëllimin e buxhetit që kishim e që e kemi dhe sot është pothuajse simbolike. Me këtë vëllim të mjeteve ishte iluzore të synohej një shoqëri e dijes. Kurrë nuk ka qenë gjendja më e rëndë në institucionet e shkencës e të hulumtimit. Dikur ka vluar jeta

shkencore dhe veçanërisht puna hulumtuese në shkencat fundamentale (me institute, laboratore, katedra, ente, bërthama shkencore, etj.). Po e nënvizoj këtë fakt, sepse prurjet në Akademi janë kryesisht nga UP-ja. Fakultet dhe departamentet janë shndërruar sot në punkte të mësimdhënies jofunkionale, ekstensive. Punë shkencore dhe veçanërisht hulumtuese nuk ka. Në vitin 2009 MASHT-i nga 0,7% të BPV e zbriti në 0,1%; as ato mjete nuk dihet ku shkuan; 1 milion euro i ndau Kuvendi i Kosovës për shkencë – edhe ato u orientuan në drejtime tjera. Konkurrues në MASHT, por as përgjigje nuk morëm.

Strategjinë e zhvillimit të shkencës e kanë bërë njerëzit jashtë MASHT-it, sikundër që Këshilli Kombëtar i Shkencës ka punuar në mjediset e Akademisë (në ndërtesën e vjetër) dhe e kanë udhëhequr njerëzit e Akademisë, ndërsa punën e tyre e ka përvetësuar MASHT-i dhe ministri i tij i atëhershëm! Ky Këshill dhe Akademia nuk janë konsultuar për asgjë, edhe pse Akademia me ligj është institucion këshillues dhe sugjerues. Nuk janë konsultuar as për hapjen e universiteteve të reja, por as për zhvillimet në shoqëri. Por Akademia nuk qëndroi duarkryq: me iniciativat e veta është prononcuar dhe ka dhënë mendimet e veta për çështje me interes të përgjithshëm përmes organizimit të tryezave dhe konferencave shkencore dhe kanë dalë botimet.

Kemi biseduar edhe vjet, që përveç ndihmës financiare që mund të ofrojë Akademia nga buxheti i vet, duhet të kërkojnë mjete plotësuese edhe në instanca tjera, si p. sh. në disa ministri (e bujqësisë, e mjedisit, e planifikimit hapësinor, e zhvillimit ekonomik, e shëndetësisë etj.); kemi kërkuar të nënshkruhen memorandumet bashkëpunimi me departamentet dhe fakultetet përkatëse për shfrytëzim të laboratoreve. Seksionet me sekretarët e tyre duhet të jenë më aktivë në këtë drejtim...

## *2. Konferenca, tryeza shkencore, akadem - kujtesa historike, ekspozita, koncerte:*

Në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, Akademia jonë ka zhvilluar një aktivitet të dendur, duke organizuar konferenca, Akademi – kujtesë historike, ekspozita, koncerte solemne në Prishtinë e gjetiu, pastaj disa anëtarë të Akademisë kanë marrë pjesë në solemnitetet qendrore në Tiranë qoftë me kumtesa, qoftë si pjesëmarrës me ftesë të Kryeministrit, Kryetares së Parlamentit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme etj. Më 25 prill u mbajt Akademia – kujtesa historike me rastin e 100-vjetorit të Shoqatës Panshqiptare "Vatra"; më 21 maj Akademia – kujtesa historike me rastin e 100-vjetorit të Kuvendit të Junikut në Junik; ndërkaq më 13-14 shtator u organizua Konferenca shkencore "Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas", ku morën pjesë me kumtesa studiues dhe historianë të shquar nga Kosova, Shqipëria, Turqia,

Maqedonia, Hungaria dhe Mali i Zi. Materialet do të botohen. U hap "Ekspozita mbarëkombëtare për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë me punime të artistëve figurativë nga të gjitha viset shqiptare"; u organizua "Koncerti solemn me vepra të kompozitorëve dhe interpretëve muzikorë mbarëkombëtarë" nën drejtimin e akad. Zeqirja Ballatës; u hapë Ekspozita e akad. Rexhep Ferri, ndërsa në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë akad. Rexhep Ferri nga kryetari i Bashkisë së Vlorës u nderua me titullin "Qytetar Nderi i Vlorës". Akad. Hivzi Islami mori pjesë në "Akademinë solemne" të organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me kumtesë shkencore "Lufta kundër faktorit demografik shqiptar si strategji afatgjate e politikës serbo-jugosllave", kurse akad. Esat Stavileci paraqiti kumtesën shkencore "Të kuptuarit e çështjes shqiptare si një çështje" në Konferencën shkencore të organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike; u organizua tryeza "Fan Noli si kompozitor dhe studiues muzikor" etj.

Anëtarë të Akademisë të të gjitha seksioneve dhe fushave morën pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore, profesionale, shoqërore jashtë Akademisë, në Kosovë dhe në botën e jashtme.

### 3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Nga raportet e deponuara dhe të miratuara nga Kryesia e Akademisë të pjesëmarrësve shihet se kontaktet dhe

bashkëpunimi me instancat ndërkombëtare, akademike dhe shkencore ka vazhduar. Nga 26-29 shkurt akad. Pajazit Nushi qëndroi në Zagreb, ku mori pjesë me referat në tryezën shkencore kushtuar historianit të shquar "M. Shufflay"; 6-8 mars Grupi ynë mori pjesë në mbledhjet e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe në Akademinë e Shqipërisë; Akad. Rexhep Ismajli mori pjesë në Kollokuiumin Ndërkombëtar na Paris nga 6-7 prill me temën "Processus et typologie de standardisation linguistique: Balkans et méditerranée"; nga 10-13 prill akad. Ismajli mori pjesë në Asambleenë e përgjithshme të ALLEA-së në Itali; nga 31 maj më 1 qershor prof. D. Pupovci mori pjesë në Konferencën me temën "Zhvillimi i IBSE – roli i vlerësimit dhe raporti me ekonominë", që u mbajt në Helsinki prej 30 majit deri më 1 qershor 2012. Tema e konferencës kishte të bëjë me qasjen zbuluese në mësimdhënien e lëndëve të shkencave (Inquiry-Based Science Education – IBSE) të cilën tani sa vite e promovojnë Paneli Ndërakademik (IAP) dhe ALLEA, të cilët edhe ishin bashkorganizatorë të konferencës së bashku me Akademinë e Shkencave dhe të Letërsisë të Finlandës dhe Universitetin e Helsinkit. Konferenca u mbajt në mjediset e Universitetit, ndërsa në të morën pjesë rreth 100 ekspertë nga të gjitha kontinentet. Në veçanti vlen të përmendet përfaqësimi i tri rrjeteve ndërkombëtare të Panelit Ndërakademik (IAP): Rrjeti i Afrikës (NASAC), Rrjeti i Amerikës Latine (IANAS) dhe Rrjeti Evropian (ALLEA).

Ndërsa tema tjetër ishte lidhja midis INSE-së dhe ekonomisë; nga 7-9 qershor në Podgoricë në Konferencën "Humanizmi dhe bota moderne" morën pjesë anëtarët korrespondentë Fejzullah Krasniqi dhe sociologu Ardian Gola me temën "Technology and the future of the human - theorizing technology sociologically" (Teknologjia dhe e ardhmja e njeriut - teorizimi sociologjik i teknologjisë); më 13 qershor në mjedisin tonë u nënshkrua Marrëveshja e bashkëpunimit midis ASHAK-ut dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë (BAN), ku mori pjesë edhe ambasadori i Bullgarisë z. Bobi Bobev; më 26-28 qershor në Tiranë qëndroi grupi ynë i gjerë për diskutimet në KNGJSH; nga 24-26 shtator akad. Nexhat Daci mori pjesë në Konferencën e tretë "The Voice of Science" të Akademisë së vendeve të Danubit, të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Evropës dhe Akademia e Shkencave e Hungarisë; nga 14-21 tetor akad. Rexhep Ismajli, në kuadër të Marrëveshjes midis Akademisë sonë dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë dhe këmbimit të kuadrove qëndroi në Sofje në institutet e Akademisë Bullgare, si Instituti i Gjuhës Bullgare, Instituti i Trakologjisë, Instituti i Studimeve Ballkanike; me kërkesë të Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve nga 7-10 nëntor qëndruan në Lubjanë akademikët Hivzi Islami dhe Eqrem Basha; akademikët Pajazit Nushi dhe Rexhep Ismajli nga 13-16 nëntor qëndruan në Entin Leksikografik "M. Kërlezha" në Zagreb për të marrë përvoja dhe për t'i zbatuar ato në

punën e Enciklopedisë sonë: Enti shprehu gatishmërinë që të vie për një trajnim te ne; këta dy kolegë i bënë një vizitë edhe HAZU-së së Kroacisë; akademikët Islami, Ismajli dhe Basha nga 6-9 dhjetor qëndruan në Académie des Inscriptions et Belle Lettres të Parisit për të përgatitur terrenin për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, që pritet të nënshkruhet deri në qershor të vitit 2013. Nga 13-15 dhjetor, me ftesë të "Aleancës Franceze në Shqipëri", akad. R. Ismajli mori pjesë në konferencën shkencore "Shqipëria dhe Franca". Seminaristët e huaj vizituan ASHAK-un në gjysmën e muajit gusht 2012.

Akademine e vizituan edhe disa përfaqësues të ambasadave të huaja, ndërsa më 13. 12. 2012 Akademine e vizitoi ish-kryeministri i Kosovës z. R. Haradinaj.

#### 4. Përrurimet

Me daljen në mesin e re, Akademia dhe seksionet e saj e zgjeruan aktivitetin e tyre dhe në përrurimin e publikimeve të veta me interes për shkencën dhe opinionin. U promovuan këto botime: "Arkitektura folklorike e rajonit të Prizrenit në shekujt VXIII-XIX" e Shpresa Siqecës; "Qymyri i Republikës së Kosovës" i akad. Minir Dushit; "Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë" të akad. Latif Susurit dhe dr. Arben Myrtajt, i cili botim u përrurua edhe në Akademine e Shkencave të Shqipërisë; "Fjalor shpjegues i termave të botanikës" si botim kolektiv, i

përbashkët i ASHAK dhe ASHSH u përrua në ASHSH, ku morën pjesë edhe autorët tanë, akademikët Feriz Krasniqi dhe Latif Susuri; dy revistat e Akademisë; "Politika, lufta dhe diplomacia (Anarkia ndërkombëtare dhe e drejta)" e akad. Muhamedin Kullashit; "Aspekti etnik i migrirove" i akad. Hivzi Islamit; "Sfidat e shtetndërtimit dhe e ardhmja e Republikës së Kosovës"; "Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore", etj. U përrua vepra kapitale e akad. Kolec Topallit "Gramatikë historike e gjuhës shqipe", etj.

##### *5. Puna e shërbimit administrativ, profesional teknik*

Puna e shërbimit administrativ, profesional-teknik po zgjerohet, po konsolidohet, po rëstrukturohet edhe më tutje në përputhje me kërkesat që po shtron zgjerimi i veprimtarisë sonë në kushtet e reja dhe përforcimin kadrovik nga radhët e trupit akademik. Disa punonjë janë pensionuar dhe po bëhet zëvendësimi me punonjë të rinj, në përputhje me normat ligjore. Punonjësit e këtij shërbimi gjatë këtij viti kanë kryer trajnime nga fusha përkatëse të punës dhe janë angazhuar që t'i kryejnë me sukses punët administrative, profesionale-teknike dhe punët tjera për nevojat e Akademisë. Po shtohet disiplina dhe përgjegjësia e punonjëseve të administratës.

Në Bibliotekën e Akademisë ka vazhduar pasurimi i fondit librar nga shkëmbimi me Akademitë dhe institucionet e tjera brenda dhe jashtë

vendit, ndonëse ka shumë punë për t'u bërë rreth organizimit të saj. E kemi vetëm një bibliotekare. Konkursi është shpallur për një përgjegjës; kanë konkurruar disa veta dhe për disa ditë do të bëhet përzgjedhja dhe pranimi. Falë kushteve të mira që ofrojnë mjediset e Akademisë e të Bibliotekës është shtuar numri i studiuesve që vijnë dhe i shfrytëzojnë librat e Bibliotekës. Akademia po merr pjesë rregullisht në panairët e librit me botimet e veta.

Krejt në fund, them se duhet të jemi më aktivë, t'i hapim këto zyre më shpesh, të organizojmë tryeza shkencore, të japim iniciativa, të paraqesim projekte afatgjata, afatmesme, afatshkurta dhe nga sot të mendojmë për programin e punës për vitin 2014. Ta mbrojmë këtë institucion autonom dhe të vetmin në Kosovë të pavarur, ta ruajmë dinjitetin e tij. Autoriteti i Akademisë varet nga puna dhe sjellja jonë. Të marrim pjesë në manifestimet shkencore dhe artistike të kësaj shtëpie; po vërehet mungesa e shumë anëtarëve në to.

Ishte ky një raportim telegrafik, sepse gati të gjitha i keni në materiale. Ju falemnderit".

##### **Ad. 1. -**

Procesverballi i mbledhjes LXXVIII të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

##### **Ad. 2. -**

Në vazhdim u shqyrtua Raporti i punës së ASHAK-ut për vitin 2012 sipas radhës, duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet e deri te raporti i

punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të Akademisë.

Raporti për punën e Kuvendit u miratua pa vërejtje, sikurse edhe raporti për punën e Kryesisë. U miratuan gjithashtu edhe raportet e seksioneve të Akademisë, si dhe Raporti i punës së Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik të ASHAK-ut.

Raporti përmbledhës i miratuar i punës së ASHAK-ut për vitin 2012 është pjesë përbërëse e këtij procesverballi. Raporti është botuar në "Vjetari" 2012.

### Ad.3. -

Kuvendi miratoi Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2012 i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverballi.

Mbledhja u mbyll në orën 13:30.

Procesmbajtës

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

## **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja LXXX e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 3 korrik 2013 në orën 11:00 në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Besim Bokshi, Engjëll Berisha, Eqrem Basha, Esat Stavileci, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi

Islami, Idriz Ajeti, Isuf Krasniqi, Mark Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Pajazit Nushi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Ruzhdi Pllana, Salih Gashi, Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi Hivzi Islami, kryetar.

Kuvendi e miratoi këtë

### *Rend dite:*

1. Miratimi i procesverballit të mbledhjes LXXIX të Kuvendit;

2. Miratimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2014;

Pas miratimit të rendit të ditës kryetari Islami në mënyrë përmbledhëse paraqiti vlerësimet e tij si më poshtë:

"Kolegë të nderuar,

Mirë se vini në mbledhjen e LXXX të Kuvendit të ASHAK-ut, në të cilën pikë qendrore është miratimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2014.

Kjo mbledhje është përgatitur gjatë dhe mendojmë mirë. Që në mbledhjen LXXIX të Kuvendit të datës 23 shkurt 2013 është kërkuar nga të gjithë të mendojmë për programet e punës së seksioneve për vitin 2014 dhe atë për botime, për projekte



afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata, për konferenca e tryeza shkencore, për iniciativa të reja, të realizueshme në rrethanat tona. Janë marrë këto propozime që i kemi sot përpara. Për këtë qëllim seksionet kanë mbajtur nga disa mbledhje dhe besoj se kanë menduar mirë. Kryesia i ka diskutuar dhe i ka sjell në Kuvend për t'i miratuar pas diskutimit të gjithanshëm.

Kurajues është fakti se shumica e anëtarëve të rinj janë treguar aktivë, duke propozuar tema konkrete shkencore dhe artistike për botim dhe për tryeza, si dhe për konferenca shkencore. Seksionet mbesin bartëse të organizimit të punës kërkimore-shkencore dhe artistike; ato duhet të jenë gjithnjë aktive, t'i marrin përsipër detyrat dhe aktivitetet që u takojnë sipas Statutit dhe Ligjit. Sekretarët e seksioneve duhet të jenë gjithnjë vigjilentë dhe aktivë se çka po punohet, sa po realizohen pikat e programeve, përfshirë bashkëpunimin me akademitë e tjera, veçanërisht me Shqipërinë, pastaj ku janë vështirësitë dhe pengesat, të kërkojnë mjete shtesë për projekte të caktuara, por me arsyetime të hollësishme, etj. Akademia po rritet dhe po zgjerohet kadrovikisht, veprimtaria dhe llojllojshmëria gjithashtu. Po ashtu administrata po zgjerohet e forcohet me kuadro profesionale.

Sa i përket Programit të punës për vitin 2014, sekretarët e seksioneve e kanë kryer detyrën e vet, por nëse duan të shtojnë apo të arsyetojnë diçka, këtë mund ta bëjnë. Jeni të lirë të gjithë anëtarët të merrni pjesë në

diskutim rreth Programit të punës për vitin 2014, me vërejtje dhe sugjerime konstruktive.

Në fund edhe një kërkesë, shumë herë e përsëritur: autoriteti i Akademisë varet nga ne, nga puna dhe angazhimi ynë dhe nga këmbëngulësia që të mbrohet dinjiteti dhe pavarësia e kësaj themelate. Anëtarët e Akademisë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore e artistike, profesionale e shoqërore jashtë Akademisë, në Kosovë dhe në botën e jashtme. Do të mbështeten dhe financiarisht për aq sa ka mundësi”.

#### **Ad. 1. -**

Procesverbali i mbledhjes LXXIX i Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

#### **Ad. 2. -**

Kuvendi shqyrtoi Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2014 dhe me disa plotësime e miratoi atë. Programi i punës së ASHAK-ut për vitin 2014 është pasqyruar më lart në pjesën e veçantë të këtij Vjetari.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.

Procesmbajtës

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami



## KRONIKA E VITIT 2013

(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përrurime...)



*Takimi solemn me anëtarët e rinj*

### **TAKIM SOLEMN ME ANËTARËT E RINJ TË RREGULLT DHE KORRESPONDENTË TË ASHAK-ut**

Në mjediset e Akademisë më 10 janar 2013 u mbajt takimi solemn me anëtarët e rinj të zgjedhur në zgjedhjet e fundit, të rregullt (akademikët) dhe korrespondentë të Akademisë. Në takim morën pjesë edhe shumica e anëtarëve të rregullt (akademikëve). Takimin e hapi kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami.



*Koncerti solemn në 5-vjetorin e Republikës së Kosovës*

### **KONCERT SOLEMN NË 5-VJETORIN E PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i saj i Arteve, kushtuar 5-vjetorit të pavarësisë së Kosovës organizuan më 15 shkurt 2013 në mjediset e ASHAK-ut koncert solemn në të cilin morën pjesë akademikë, pedagogë e studentë të artit, personalitete të shquara të muzikës nga Shqipëria si Avni Mula dhe Zhani Ciko dhe përfaqësues të mediave. Koncertin e shpalli të hapur kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami.

Në vazhdim: Luan Durmishi, tenor, Arta Jashari, soprano, Besa Llugini, soprano, Lule Ballata, pikolo flaut, Ardiana Bytyçi, mexosoprano, Astrit Mustafa, (bas) klarinet, Ergin Brahimi, bariton, Lirika Pula, piano, Pranvera Hoxha, piano, Riad Ymeri, tenor, me dirigjent akademik Zeqirja Ballatën realizuan programin e paraparë.



*Akademik Kolec Topalli me akademik Hivzi Islamin, kryetar i ASHAK-ut*

### **LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK KOLEC TOPALLIT ANËTAR I JASHTËM I ASHAK-ut**

Me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Kolec Topalli, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 28 shkurt 2013 ka mbajtur ligjëratën inauguruese me temë: Disa rezultate në studimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe.

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, medimeve dhe të interesuarve të tjerë, fjalën e rastit e

### **AKADEMIK NEXHAT DACI NË KONFERENCËN E AKADEMIVË TË DANUBIT (4<sup>th</sup> Danube Conference)**

Më 9-10 prill 2013 akademik Nexhat Daci ka përfaqësuar ASHAK-un në Konferencën e organizuar nga Akademia Rumune me titull Science and European Danube Strategy. Profesor Daci në Konferencën e lartpërmendur ka marrë pjesë me punimin Impacts of Thermo Power Plants Pollution on Human Biochemical Blood Parameters-Kosova Case.

### **LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK ALAJDIN ABAZIT ANËTAR I JASHTËM I ASHAK-ut**

Me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Alajdin Abazi, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 24 prill 2013 ka mbajtur ligjëratën inauguruese me temë: Konceptet e rrjetave energjetike inteligjente dhe kualiteti i fuqisë.

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, medimeve dhe të interesuarve të tjerë, fjalën e rastit e mbajti kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami.

### **LIGJËRATË INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI**

Në mjediset e Akademisë, më 15 maj 2013 anëtari korrespondent Arsim Bajrami mbajti ligjëratën inauguruese me temën: Argumentimi kushtetues juridik i pavarësisë së Kosovës dhe vendimi i GjND-së. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, tha se ligjëratat inauguruese po mbahet me rastin e zgjedhjes së prof. Bajramit anëtar korrespondent i ASHAK-ut.

### **PËRURORHET VEPRA E AKADEMIK ESAT STAVILECIT “TË SHKRUARIT DHE TË MENDUARIT JURIDIK”**

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, të interesuarve të tjerë dhe medimeve, më 20 maj 2013 në mjediset e Akademisë u përurua libri i akademik Esat Stavilecit “Të shkruarit dhe të menduarit juridik”. Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi. Më pas fjalën e mori recensenti i librit akademik Pajazit Nushi, pastaj dr. Blerim Reka.

### **AKADEMIK REXHEP FERRI NDEROHET ME ÇMIMIN “PERSONALITET I SHQUAR (në fushën e artit)”**

Akademik Rexhep Ferri, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, është nderuar nga Këshilli i Qarkut të Kukësit me titullin “Personalitet i shquar (në fushën e artit)”, me motivacionin: “Për afirmimin e vlerave të Qarkut të Kukësit nëpërmjet veprimtarisë së tij artistike dhe akademike në fushën e pikturës dhe krijimtarisë letrare”. Fletëdëshmia i është dorëzuar në një ceremoni rasti dhe pritjeje madhështore nga kryetari i Qarkut të Kukësit zoti Ibsen Elezi më 8 maj 2013.

### **LIGJËRATË INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT RUZHDI PLLANA**

Në mjediset e Akademisë, më 4 qershor 2013, anëtari korrespondent Ruzhdi Pllana mbajti ligjëratën inauguruese me temën: „Karakteristikat morfohidrologjike të karstit të Kosovës”. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës akademik Fejzullah Krasniqi.

### **MBAHET TRYEZA SHKENCORE ME TEMËN: Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike**

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temën: “Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike”. Tryeza u mbajt më 7 qershor 2013 në mjediset e Akademisë. Në tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, punonjës të Institutit Albanologjik, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi me një fjalë rasti akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Në vazhdim kontributet e tyre i paraqitën: Ali Aliu, Sabri Hamiti, Dhurata Shehri, Ardian Marashi, Fatmir Sylejmani, Floresha Dado, Bashkim Kuçuku, Kujtim M. Shala, Ymer Çiraku, Shaban Sinani, Nehas Sopaj, Persida Asllani, Stefan Çapaliku, Vjollcë Berisha, Nysret Krasniqi, Laura Smaqi, Kastriot Gjika, Salajdin Saliu.

### **NËNSHKRUHET PROTOKOLLI I RI I BASHKËPUNIMIT MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të vitit 2000 nënshkruan në Tiranë (në mjediset e ASHSH-së) më 13 qershor 2013 Protokollin e bashkëpunimit për vitet 2013-2015. Protokollin u nënshkrua nga Akademik Salvator Bushati, sekretar shkencor i ASHSH-së dhe Akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë: akademik Gudar Beqiraj, kryetar, akademik Muzafer Korkuti, zëvendëskryetar, akademik Salvator Bushati, sekretar shkencor, akademik Jorgo Bullo, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, akademik Dhimitër Haxhimihali, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike dhe akad. asoc. Efigjeni Kongjika, sekretare e Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, akademik Pajazit Nushi, nënkryetar, akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm dhe znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë.



**PËRUIROHET VEPRA E DR. ARSIM  
EJUPIT “LUGINA E PRESHEVËS -  
STUDIM KOMPLEKS  
GJEOPHËSINOR”**

Në mjediset e ASHAK-ut, më 19 qershor 2013 u përrua vepa e Dr. Arsim Ejupit me titull: “Lugina e Preshevës - studim kompleks gjeopshësinor”. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti anëtari korrespondent Jusuf Bajraktari. Pastaj për vlerat e librit folën: Akademik Pajazit Nushi dhe akademik Hivzi Islami. Në fund autori i veprës dr. Arsim Ejupi falënderoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që ia dha mundësinë e botimit të veprës së tij.

**KRYETARI I ASHAK-ut VIZITON  
AKADEMINË BULLGARE TË  
SHKENCAVE**

Në vazhdën e vizitave të ndërsjella, të mbështetura në Marrëveshjen për bashkëpunim shkencor dhe artistik midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, nga data 20-21 qershor në Sofie qëndruan kryetari i ASHAK-ut akademik Hivzi Islami, akademik Rexhep Ismajli dhe akademik Eqrem Basha. Vizita u realizua me ftesë të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë për diskutimin e bashkëpunimit të mëtejshëm shkencor dhe artistik në vitin që vjen, si dhe për realizimin e pikave të mbetura nga programi i mëhershëm.

**MBAHET TRYEZA SHKENCORE ME  
TEMËN: “Depërtimi dhe përshtatja  
e huazimeve angleze në gjuhën  
shqipe”.**

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temën: “Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe”. Tryeza u mbajt më 27 qershor 2013 në mjediset e Akademisë. Në tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, punonjë të Institutit Albanologjik, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi akademik Mehmet Kraja, ndërsa kontributet e tyre i paraqitën: Rexhep Ismajli, Vesel Nuhju, Jani Thomai, Bardh Rugova, Shykrane Gërmizaj, Jashar Kabashi, Arta Toçi, Valter Memisha, Linditë Sejdiu - Rugova, Agron Duro, Drita Kadriu, Nebi Caka, Irena Pata Kapo, Muhamet Hamiti, Shkumbin Munishi, Albana Ndoja, Dieter Nehring.



## **PËRURORHET VEPRA E PLOTË E ALI PODRIMJES**

Më 5 korrik 2013, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u bë paraqitja e botimit të veprës së plotë të poetit dhe akademikut Ali Podrimja. Me këtë rast folën akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, akademik Hivzi Islami, kryetar i ASHAK-ut, akademik Ali Aliu dhe akademik Rexhep Ismajli. Të pranishëm ishin znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, z. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Memli Krasniqi, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, familja e poetit Podrimja, anëtarët e Akademisë dhe shumë të ftuar të tjerë.

## **KRYETARI I FEDERATËS SË AKADEMIVE EVROPIANE VIZITON ASHAK-un**

Kryetari i Federatës së Akademive Evropiane (All European Academies - ALLEA), prof. dr. Günter Stock ka qëndruar për vizitë zyrtare në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 29-30 gusht. ALLEA është federatë e 55 akademive të shkencave dhe të arteve nga pothuaj të gjitha vendet e Evropës, 40 prej tyre anëtare të Këshillit të Evropës. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është anëtare e ALLEA-s që nga viti 2004. Më 29 dhe 30



*Prof. dr. Günter Stock*

zhvilluar vizita e takime njohëse me anëtarë të tjerë të ASHAK-ut. Z. Islami e ka njoftuar z. Stock me punën dhe veprimtarinë e Akademisë dhe me projekte të veçanta shkencore e hulumtuese që realizohen nga anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Akademisë. Akademik Hivzi Islami, kryetar i ASHAK-ut e njoftoi kryetarin e ALLEA-s për rrugën e zhvillimit të akademisë dhe për synimet e saj në të ardhmen, për përpjekjet për ta ruajtur autonominë, etj. Dr. Shtok tha se sfidat e sotme nuk dallojnë shumë nga sfidat e djeshme, siç është globalizmi, energjia, ambienti, etj. Akademitë sot duhet të bashkohen për të përballuar këto sfida, theksoi ai. Kryetari i ALLEA-s përkujtoi se në disa vende të Evropës ka pasur



*Pjesëmarrësit në trajnimin për fjalorin enciklopedik*

përpjekje nga pushteti për të ndikuar në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të akademive ose të udhëheqjeve të tyre, apo në imponimin e rregullave të paracaktuara nga pushteti. Ai e ilustroi këtë me rastin e Turqisë, ku po hartohet një ligj i ri për akademinë, i cili, siç tha dr. Shtok, mund të cenojë pavarësinë e akademisë. "Ne i kemi shkruar presidentit Gyl dhe kemi shprehur shqetësimin tonë. Deri më tash nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga presidenti për shqetësimin tonë, por letra jonë ka hasur në reagime të fuqishme pozitive të institucioneve të shkencës e të dijes dhe të shoqërisë civile", tha ai. "Tani e kemi edhe rastin e Akademisë së Rusisë, njërës ndër akademitë më

të vjetra të Evropës. Edhe atje presidenti Putin po harton një ligj për akademinë, me të cilin ajo mund të vihet nën kontrollin e politikës dhe të pushtetit. Ne do të shkojmë në Moskë dhe do të përpiqemi të bindim autoritetet ruse se pa autonomi të akademisë nuk ka dije", thekoi Shtok. Kryetari i ALLEA-s, Gynter Shtok, ka folur edhe për një numër aspektesh të rëndësishme për promovimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe të dijes së kosovarëve. Ai ka falënderuar në veçanti Akademik Rexhep Ismajlin për punën e tij në zgjerimin e bashkëpunimit me akademitë evropiane dhe kontributin e tij për realizimin e vizitës së tij në Prishtinë.



## TRAJNIMI PËR FJALORIN ENCIKLOPEDIK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Redaksia Qendrore e FEK-ut ka organizuar Takim pune për Fjalorin enciklopedik të Kosovës në Durrës nga 19 - 22 shtator 2013. Në takim kanë marrë pjesë: Bordi i Fjalorit enciklopedik të Kosovës, Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të FEK-ut, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse.

Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.

## ASHAK PREZANTON BOTIMET E VETA NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR "FRANKFURTI

2013"

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është prezantuar me botimet e veta në Panairin Ndërkombëtar "Frankfurti 2013", që është mbajtur nga data 9-13 tetor. Më 11 tetor 2013, gazeta "Zëri" në portalin e saj (shih artikullin: <http://www.zeri.info/artikulli/17312/kosova-megjithate-dinjitoze-ne-panairin-e-librit-ne-frankfurt>) raporton se paraqitja e botuesve kosovarë ka qenë dinjitoze. "Botuesit si ASHAK, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Koha, Buzuku, Dukagjini etj. e arsyetojnë pjesëmarrjen dhe të arriturat në fushën e librit në Kosovë, e cila mund të quhet megjithatë e suksesshme dhe dinjitoze!"



*Përurimi i veprës së plotë të poetit dhe akademikut Ali Podrimja në Tiranë*

## **PËRURUHET EDHE NË TIRANË VEPRA E PLOTË E ALI PODRIMJES**

Pas përrurimit në Prishtinë vepra e plotë e Ali Podrimjes u përrurua edhe në Tiranë. Përrurimi u organizua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe u mbajt më 10 tetor 2013 në orën 18:00 në mjediset e hotelit Tirana International. Solemnitetin e hapi dhe e moderoi shkrimtari Zija Çela, ndërsa për akademik Podrimjen dhe veprën e tij folën ministrja e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro, Bashkim Kuçuku, Visar Zhiti, Ali Aliu dhe Rexhep Ismajli. Në përrurim nga Akademia jonë morën pjesë edhe akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë, si dhe shumë të ftuar të tjerë në mesin e të cilëve akademikë, shkrimtarë të njohur, profesorë universitarë, adhurues të shumtë të poezisë së akademik Podrimjes, si dhe përfaqësues të mediave.

## **ANËTARJA KORRESPONDENTE E ASHAK-ut EDI SHUKRIU MERR PJESË NË TAKIMIN I TË KOMITETEVE NACIONALE TË EVROPËS JUGLINDORE TË ICOMOS.**

Më 10-13 tetor 2013 anëtarja korrespondente Edi Shukriu ka qëndruar në Vjenë për të marrë pjesë në Takimin I të Komiteteve Nacionale të Evropës Juglindore të ICOMOS, organizatës për trashëgimi kulturore.

Tema e takimit ka qenë Bashkëpunimi rajonal - trashëgimi e përbashkët dhe thesar në rajonin e Evropës. Takimi është bazuar në programet e Unionit Evropian për trashëgimi kulturore (Programi kulturor 2014-2020) dhe ICOMOS-Grupit të Evropës (qershor 2011) me të cilat mundësohet bashkëpunimi shkencor i anëtarëve të ICOMOS në rajon. Në takim është pranuar edhe bashkëpunimi me shkencëtarët e Kosovës dhe është rekomanduar themelimi i Komitetit Nacional të Kosovës si në vendet e tjera në rajon dhe në botë.



*Prof. dr. Edi Shukriu*

### **MSC. ARDIAN GOLA PËRFAQËSON ASHAK-un NË PODGORICË**

Më 16-18 tetor 2013, msc. Ardian Golan në emër të ASHAK-ut ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me titull: Young Scientists and Science in the Region. Z. Gola në Konferencë është paraqitur me temën Research practices in Kosova-Challenges in Humanities and Social Sciences.

### **PËRURORHET MONOGRAFIA TAHIR EMRA**

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 23 tetor 2013 u përurua Monografia Tahir Emra, me autor Kujtim Buzën, artist i merituar. Për botimin folën: sekretari i Seksionit të Arteve akademik Zeqirja Ballata dhe Kujtim Buza, artist i merituar.

vizitoi delegacioni i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, përkatësisht kryetari i saj akademik Stefan Vodenicharov D. sc. dhe sekretarja e përgjithshme shkencore prof. Evdokia Pasheva D sc. Delegacionin në orët e pasdites e priti kryetari i ASHAK-ut akademik Hivzi Islami me bashkëpunëtorë. Më 25 tetor 2013, për nder të mysafirëve u mbajt mbledhje solemne e Kryesisë së Akademisë, me ç'rast anëtarët e saj njoftuan më për së afërmi me punën dhe veprimtarinë e Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Po këtë ditë në Amfiteatrin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kryetari Vodenicharov mbajti një ligjëratë. Të pranishëm me këtë rast ishin edhe ambasadori i Bullgarisë z. Bobi Bobev dhe të ftuar të tjerë.

### **MBAHET KONFERENCA SHKENCORE Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm**

Seksioni i Shkencave të Natyrës i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi Konferencën shkencore me titull: "Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm". Konferenca u mbajt më 30 tetor 2013 në mjediset e ASHAK-ut. Në të morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Ramë Buja, rektori i Universitetit të Prishtinës z. Ibrahim Gashi, z. Ramush Haradinaj, kryetar i AAK-së, profesorë universitarë, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Konferencën e hapi akademik Fejzullah Krasniqi, e përshëndeti dr. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, i cili përshëndeti edhe në emër të Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi.



*Akademik Tahir Emra*

### **DELEGACIONI I AKADEMISË SË SHKENCAVE TË BULLGARISË VIZITON ASHAK-un**

Më 24 tetor 2013 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e





*Delegacioni i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë gjatë takimit në ASHAK*



*Këshilli organizativ dhe shkencor i Konferencës shkencore "Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm"*

## ASHAK PREZANTON BOTIMET E VETA NË PANAIRIN E 16 TË LIBRIT TIRANA 2013.

Nga data 13 deri 17 nëntor, në Tiranë është mbajtur Panairi i 16-të i librit Tirana 2013. Në mesin e rreth 90 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, përfshirë ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikë dhe Francës, si dhe Përfaqësia e BE-së në Shqipëri, me botimet e veta është paraqitur edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.



*Pamje nga Panairi i 16-të i librit në Tiranë*

### **MBAHEN NË PRISHTINË MBLEDHJET E KRYESISË DHE TË KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE**

Më 6 dhjetor 2013 në Prishtinë, në mjediset e Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt mbledhja

e radhës e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. Mbledhja u mbajt nën drejtimin e akademik Rexhep Ismajlit dhe akademik Jani Thomait (bashkëkryetarë) me pjesëmarrjen e akademik Besim Bokshit, akademik Ethem Likajt, akademik Gjovalin Shkurtajt, akademik Kolec Topallit, prof. dr.

Tomor Osmanit, prof. dr. Seit Mansakut, prof. dr. Imri Badallajt, prof. dr. Enver Hysës, prof. dr. Bardh Rugovës, prof. dr. Shefkije Islamajt, prof. dr. Abdullah Zymberit dhe Isa Bajçincës. Në pamundësi për të marrë pjesë vetë, diskutimet lidhur me materialet e dërguara paraprakisht i kishin dërguar me shkrim prof. dr. Franko Altimari dhe prof. dr. Mehmet Çeliku. Mbledhja u mbajt sipas rendit të ditës të parashtruar më herët. Pikë qendrore e rendit të ditës ishte diskutimi i materialeve të përgatitura nga komisionet për çështje të morfologjisë në Tiranë dhe në Prishtinë. Komisionet kishin përmbledhur në dy materiale të ndara me detaje dhe lëndë ilustrimi pikat në rregullat ekzistuese të drejtshkrimit për të cilat ka pasur diskutime në opinion ose ato për të cilat anëtarët e komisioneve e kanë gjykuar të nevojshme të diskutohet. Materialet e paraqitura me shkrim u diskutuan për çdo pikë veç e veç dhe

me frymë të theksuar mirëkuptimi. Pasi u dëgjuan të gjitha diskutimet Këshilli arriti këto përfundime:

1. Pas diskutimeve për format e shumësit të disa emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me -i të theksuar të sanksionuar si shumësia me -nj, u arrit përfundimi të propozohet që këta shumësia të përfundojnë me -j.

Këtu përfshihen rrjedhojat që në temë kanë një shumës të tillë;

2. U miratua propozimi që te foljet që pësojnë ndryshimin -t/-s të mbetet normative vetëm forma me -s;

3. U miratua propozimi që forma e rasës kallëzore të shquar tek emrat që mbarojnë me -ua: krua, kroi të rrafshohet sipas tipit të përgjithshëm të ndërtimit të këtyre formave të emrave mashkullorë, pra krua-kroi-kroin, ashtu si dhe trajta e kallëzores së shquar të emrave mashkullorë që dalin me -a ose -e të theksuar (again, babain, jubileun, atdheun);



*Mbledhja e Këshillit ndërkademiç për gjuhën shqipe*



4. U konsideruan si gabime prirjet në përdorim të formave të zhdrejta të përemrave pronorë të gjinisë femërore ime, jonë, jote dhe juaj si vajzës time, vajzës tonë, vajzës tënde, vajzës tuaj dhe kërkohet respektimi i normës ekzistuese, pra vajzës sime, vajzës sate, vajzës sonë, vajzës suaj;

5. Përdorimi i trajtave të lidhore pa formantin të (p. sh. do laj) konsiderohet shkelje e normës; formë e vetme e drejtë konsiderohet forma me të: do të laj;

6. Tek urdhërorja joveprore e foljeve të tipit kruaj, ruaj duhet të mbetet normative forma me -j (ruaju, kruaju) dhe jo me -h (kruhu, ruhu);

7. Rastet e tjera të sistemit emëror dhe foljor, të cilat mund të dalin me zgjidhje të veçanta, mbetet të studiohen dhe të diskutohen në mbledhjen e radhës të Këshillit, bashkë me çështjen e përdorimit të shkronjës së madhe;

8. U arrit përfundimi që të mos mbështetet prirja për respektimin e ambigjinitë tek emrat shumës më -ra (fshatra të elektrizuara, ujëra të ftohta) dhe të konsiderohet si normative vetëm forma e gjinisë mashkullore (fshatra të elektrizuar, ujëra të ftohtë).

9. U vendos që në mbledhjen e radhës të Këshillit të merren në shqyrtim çështjet e mbetura nga kjo mbledhje dhe nga mbledhja e kaluar, e që lidhen me drejtshkrimin dhe me morfologjinë, si dhe ato që do të propozojnë grupet e punës për çështje sintaksore.

## **ANËTARI KORRESPONDENT SALIH GASHI MERR PJESË NË TAKIMIN VJETOR TË GRUPI PUNUES PËR SHKENCË DHE EDUKIM TË ALLEA-S**

Më 19-21 nëntor anëtari korrespondent i ASHAK-ut ka qëndruar në Dublin, me ç'rast ka marrë pjesë në takimin vjetor të grupi punues për shkencë dhe edukim të ALLEA-s. Profesor Gashi ka prezantuar në takim të arriturat dhe projektet që janë zhvilluar dhe janë në zhvillim e sipër në institucionet e Kosovës.

### **TRYEZA SHKENCORE “Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integruet të Kosovës”.**

Seksioni i Shkencave Shoqërore i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temën: “Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integruet të Kosovës”. Tryeza u mbajt më 27 dhjetor 2013, në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi akademik Mark Krasniqi. Në vazhdim kontributet e tyre i paraqitën: Isa Mustafa, Muhamet Mustafa, Lumir Abdixhiku, Premton Hyseni, Venera Demukaj, Dr. Avdullah Hoti, Dr. Besnik A. Krasniqi, Hafiz Leka, Ymer Havolli.



*Pamje nga tryeza shkencore "Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integrujes të Kosovës"*



*Pjesëmarrës nga mbledhja e Këshillit ndërkademiç për gjuhën shqipe*



**VJETARI**

**2013**

*Botues*

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Lektor:*

Shefqet Riza

*Redaktor teknik:*

ASHAK

*Realizimi kompjuterik:*

ASHAK

*Madhësia:* 5.7 tabakë shtypi

*Tirazhi:* 200 copë

*Formati:* 16x24 cm

*Shtypi:*

Focus Print

Shkup